

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
DEPARTAMENTI
GJUHËT, KULTURAT DHE KOMUNIKIMI



PUNIM MASTERI

Tema: Menaxhimi i procesit edukativ dhe arsimor i shkollës fillore dhe ciklit parashkollor në fshatin Zhur

Mentori/ja:
Prof. Dr Arafat Shabani

Kandidati/ja:
Afrodita Drini

Tetovë, 2017

ABSTRAKTI

Ardhmëria e ndritshme e një kombi është e bazuar në nivelin e edukimit të fëmijëve të tij. Edukimi kualitativ fillon në fëmijërinë e hershme. Veçanërisht e rëndësishme mbetet lidhja e sistemit të edukimit, e cila duhet të jetë bazë për arritjen e cilësisë në edukimin e personit bashkëkohor. Problemet dhe dilemat e shumta të sistemit të edukimit parashkollor janë: cila është dhe ku duhet bazuar programi i duhur në edukimin dhe zhvillimin? A janë mësuesit edukatorët “më të mirë”. Cfarë duhet të jetë ambienti për mësim dhe zhvillim? Cili është dhe duhet të jetë roli i prindëve në edukimin e fëmijëve? Cila është metoda e vlerësimit? Cfarë zhvillimi profesional duhet të ken edukatorët?

Pra, ky hulumtim jep përgjigje këtyre shqetësimeve dhe pyetjeve reth edukimit parashkollor dhe rregjistrimit të fëmijëve në ciklin e parë të bashkëpunimit mes trekëndëshit: Instituti Parashkollor – Shkolla Fillore – Drejtoria Komunale e Arsimit.

Fjalët kyçe: Shkolla, fëmijët, zhvillimi profesional, kurrikula parashkollore, edukatori.

ABSTRACT

The bright future of a nation is based on education level of its children. Qualitative education is the one in early childhood. Like crucial and specially important link in the system of education, which should be the basis for achieving quality in the education of modern person, before preschool educational system numerous dilemmas and problems like: What is and on what should be based the good program on early learning and development? Are teachers, educators “best” professionals? Are child doctor of its own development? What is and what should be the environment for learning and development? What is it and what is the role of parents? What is the method of evaluation? What professional development do educators need?

So, this research provides answer to these problems and questions related to preschool education and the registration of children in first grade corporation between the triangle: Institution Preschool- Elementary School- Municipal Directorate of Education.

Keywords: School, children, professional development, preschool curriculum, educator

Абстракт

Цвета иднина на една нација се базира на нивото на образование на најзините деца. Квалитативно образование започнува во раното детство . Особено важно е поврзавноста на образовниот систем, која треба да биде основа за постигнување на квалитетот во образованието на современо лице. Проблемите и дилемите на системот за предучилишно образование се , Кој е и каде треба да се заснова вистинската програма за образование и развој? Дали се воспитувачите и наставниците’’ најдобри’’ професионалци? Дали се лекарите деца во развој ? Која е и треба да биде средина за учење и развој? Што е и треба да биде ологата на родителите? Која е метода за оценување? Каков професионален развој треба да имат воспитувачите?

Значи, ова истражување одговара на овие загрижености и прашања во врска со предучилишното образование и запишувањето на детето во првиот циклус на соработка помеѓу триаголникот; Претшколски институт - основно училиште - Општинска дирекција за образование.

Клучни зборови; училишта, деца со стручен развој, предучилишни програми, воспитувачите.

PARATHENIE

Prej këtu dhe me gjithë zemër e falenderoj edukatorin, profesorin dhe mentorin tim dr Arafat Shabanin për mundin dhe kujdesin e tij të shtuar që ka treguar ndaj meje dhe për të më udhëhequr me përkushtim. Pa ndihmën dhe sugjerimet e tij kjo diplomë për gradën e masterit nuk do të ishte kurorëzuar me kohë.

Nga ana tjetër, ky punim është edhe rezultat i pamohueshem i të gjithë profesorëve të mi të cilët më kanë pajisur me dije gjatë katër vjet studimi nga fusha e kulturës së përgjithshme si edhe asaj edukative dhe arsimore në Fakultetin e Edukimit në Prishtinë gjatë studime themelore dhe në Departamentin për Gjuhët, Kulturat dhe Komunikimin në Universitetin e Evropës Jug-lindore në Tetovë gjatë studimeve pas diplomike.

Në pamundësi për t'i përmendur veç e veç, i falenderoj edhe të gjithë ish-nxënësit e asaj kohe të cilët më kanë ofruar të dhëna gojore për periudhën kur ata vet kanë qenë nxënës në Zhur. Pa ndihmën e tyre ky hulumtim do të çalonte. Me ata njerëz kam biseduar për mësuesin e tyre të parë, për kushtet e mësimit, për përrgatitjen e tyre shkollore për numrin e nxënësve në një klasë, etj.

Në fund dhe me patjetër i falenderoj të gjithë ata që në një mënyrë ose tjetër kanë kontribuar në kërkimin tim për marrjen e gradës master në fushën e edukimit parashkollor.

PËRMBAJTJA

Abstrakti.....	1
Parathënie.....	4
Përmbajtja.....	5
Hyrje.....	8
1. PJESA E PARË.....	13
1.1 Fillet e arsimit në Zhur.....	13
1.2 Veprimtaria ndër vite e shkollës fillore në Zhur dhe menaxhimi i saj.....	16
1.3 Zhvillimi i procesit mësimor.....	17
1.4 Arsimi fillor.....	18
1.5 Kuadri edukativ, organet e shkollës dhe këshilli I arsimtarëve.....	23
1.6 Shpërndarja e nxënësve si proces i paevitueshëm.....	28
1.7 Mjedisi shkollor.....	31
2 PJESA E DYTË.....	33
2.1 Fillet e edukimit parashkollor në Zhur.....	33
2.2 Bashkëpunimi i shkollës me prindër.....	35
2.3 Organizimi i aktiviteteve shkollore.....	39
2.4 Të drejtat dhe detyrat e fëmijës.....	41
2.5 Të drejtat dhe detyrat e e dukatorit.....	41
2.6 Te drejtat dhe detyrat e personelit ndihmes.....	42
2.7 Të drejtat dhe detyrat e prindit.....	42

2.8 Lista e teksteve dhe mjeteve edukativo arsimore që përdoren aktualisht gjatë punës në kopsht.....	43
2.9 Programet sipas grupmoshave.....	45
2.10 Planifikimi mësimor dhe metodat.....	47
2.11 Faktorët kryesorë që ndikojnë në përgatitjen e fëmijëve parashkollorë.....	49
2.12 Institucionet edukative.....	55
2.13 Niveli i arsimimit të prindërve.....	56
2.14 Puna me fëmijët e moshës 1-3 vjeç.....	57
2.15 Puna me fëmijët e moshës 3-6 vjeç.....	57
2.16 Realizimi i programit përgatitor parashkollor.....	61
2.17 Bashkëpunimi me rrethin shoqëror.....	62
2.18 Përsosja profesionale e kuadrit arsimot.....	62
2.19 Realizimi i punës sociale.....	62
3. PJESA E TRETË.....	64
3.1 Nga teoria në praktikë.....	64
3.2 Zhvillimi kognitiv, social, emocional, motorik, gjuhësor, matematikor.....	64
3.3 Hospitimi im në kopshtin e fëmijëve.....	65
3.4 Plani, programi dhe ditari edukimit parashkollor.....	67
3.5 Njësit mësimore.....	73
4. Përfundim.....	102
5. Bibliografia.....	105

HYRJE

Qëllimi im kryesor ka qenë që në këtë hulumtim, të vihen në pah angazhimet e palodhshme dhe të vazhdueshme të mësuesve dhe të menaxhmentit të shkollës fillore të Zhurit si dhe rezultatet e tyre të arritura nga viti në vit duke u bazuar në planprogramet e atëhershëm që nga viti 1945 kur edhe u hap, në këtë vend, shkolla e parë në gjuhën shqipe.

Ndërkaq, për hartimin e këtij punimi kam shfrytëzuar lëndën arkivore të vet shkollës si dhe ato të arkivit të qytetit të Prizrenit ku çdo herë kam hasur në mirëkuptim dhe bashkëpunim me të gjithë.

Gjatë hulumtimit të të dhënave arkivore jam ndeshur edhe me pengesa. Në disa raste, për shembull, ka munguar dokumentacioni pedagogjik e juridik shkollor në Zhur si dhe disa të dhëna të tjera të çmuara për pasqyrimin edhe më të plotë të punës edukative dhe arsimore në këtë fshat. Për ta plotësuar mungesën e dokumentave, kam bërë hulumtime edhe në arkivin e Kosovës dhe në fund kam qenë e shtrënguar të takoj nxënësit e asaj kohe për ta plotësuar atë zbrazëti.

Gjatë eksplorimit të literaturës, kam vërejtur gjithashtu se disa autorë të cilën njihen sot si autoritete të pedagogjisë, bijnë në kundërshtim rreth të njëjtit faktor që ka të bëjë me formimin e personalitetit të fëmijëve parashkollorë.

Në pjesën e dytë të këtij punimi, do të mundohem t'i paraqes kundërthëniet mes tyre, por do të mundohem gjithashtu ta marr guximin për ta thënë mendimin tim rreth kësaj çashtje e cila mund të jetë edhe e gabuar.

Në pjesën e tretë dhe të fundit, do t'i vë në spikamë vështirësitë e shumta që i kam hasur, sidomos në terren, ku me gjithë përpjekjet, nuk kam mundur të arrijë atë që kërkoja. E kam të dëgjuar se kjo ju ndodhë të gjithë atyre që mundohen që hulumtimi i tyre të jetë i përsosur. Pra, shumëçka gjatë punës në terren mbetet e pashpjegueshme. U mbetet hulumtuesëve tjerë t'ia arrijnë këtij qëllimi.

Dua gjithashtu që t'i paraqes në formë të përmbledhur, parametrat kryesorë të cilët janë një domosdo për punimin e një masteri.

1. Lënda e hulumtimit:

Duke pasur parasysh se arsimimi është shtyllë e një shoqërie të civilizuar, në vendin tone iu ka kushtuar vendi më me rëndësi arsimimit solid të gjitha gjeneratave që nga viti 1945 deri në ditët e sotme. Për ta parë sa ka përparuar arsimimi prej asaj kohe më së miri e tregon punimi i ynë modest. Deri sa në atë periudhë nuk kishte as mësues të kualifikur sot e kemi një gjendje krejtë ndryshe. Vet shkollat fillore, të mesme dhe universitetet e shumtë janë dëshmi e një përparimi marramendës. Natyrisht, gjatë rrjedhës së dekadave janë ndërruar planet dhe programet dhe në këtë mënyrë janë kryer reforma në arsim. Arsimimi I të rinjëve vazhdon me hapa viganë dhe do të vazhdojë kështu në mënyrë që popullata e vendit tone të shkojë me një hap me vendet e përparuara europjane. Punimi im, i cili lidhet vetëm me një shkollë fillore dhe parafillore. Në këtë punim e kemi trajtuar historikun e edukimit dhe arsimimit e një institucioni në Kosovë me theks të veçantë mbi historikun e arsimit të shkollës fillore dhe parashkollore në Zhur të Prizrenit dhe menaxhimi i tyre në rrjedhën e decenive. Nëpërmes të këtij hulumtimi rreth shkollës së Zhurit e shohim edhe nivelin e ngjajshëm të shkollave të ciklit fillor dhe parafillos në gjithë hapësirën kosovare. E shohim edhe transformimin rrënjësor të shkollimit shqip.

Vend me rëndësi në këtë punim do t'i kushtojmë edukimit parashkollor i cili paraqet nivelin e parë, gjatë të cilit fëmijët edukohen në familjet e tyre ose në institucione parashkollore dhe në shkollat fillore. Niveli I edukimit parashkollor 'nde nuk e ka zënë vendin që e meriton në kuadër të sistemit të arsimit dhe shoqërisë tone në tërësi.

Më duket e domosdoshme që, paraprakisht, ta definoj termin menaxhim për arsye se punimi ynë fund e krye lidhet me menaxhimin e një institucioni arsimor.

Sipas Fjalorit sinonimik të gjuhës shqipe¹ del se fjala menxhim është me origjinë latine, ndërkaq me kohë ka dhënë në frëngjisht, *ménagement* » të cilën e kanë trashëguar më vonë edhe gjuhë tjera europjane. Kjo fjalë në të vërtetë del me disa nuansa kuptimore që po i radhisim si vijon. : menaxhim = kujdes, udhëheqje, kursim, organizim, rregullim. Pra kjo fjalë ka shumë nuansa kuptimore, por në rastin tonë, në gjuhën shqipe, del me kuptimin organizim dhe udhëheqje.

¹ *Fjalori sinonimik i gjuhës shqipe*, Ali Dhrimo, Edmond Tupja dhe Eshref Ymeri, 2002, Tiranë

2. Qëllimi i hulumtimit:

Qëllim i hulumtimit i ciklit parashkollor është të përcaktohen efektet e edukimit gjatë moshës parashkollore në nivelin e gatishmërisë për klasë të pare. Këtu do të kihet parasysh forma e edukimit parashkollor, niveli i edukimit parashkollor, niveli I edukimit të prindërve, vendi ku jeton fëmija si dhe realizimi i plan-programeve të parapara duke filluar nga themelimi I kopshteve, kushteve të punës në këto ente parashkollore, zbatimit të tyre dhe rezultateve të arritura përmes shembullit të shkollës fillore dhe kopshtit në Zhur. Në të vërtetë në vet këtë shkollë, me kalimin e kohës, janë bërë përparime enorme në edukimin parafillor dhe fillor. Në saje të përgatitjes së trupit arsimor, nxënësit kanë arritur një nivel të lakmueshëm, ndonëse ky edhe ka qenë qëllimi I kësaj shkolle.

3. Hipotezat

Në mungesë të edukimit superior në Kosovë pak kush është marrë me formimin dhe punën e enteve parashkollore, hulumtimin e programeve të tyre dhe përgatitjes së edukatorëve përkatës që nga themelimi I kopshteve në Kosovë. Ne jemi munduar që të hedhim në dritë punën dhe rezultatet e institucioneve parashkollore në mënyrë që edukatorët e rinjë ta kenë një mbështetje sado modeste të jetë ajo.

Nisur nga kjo ide kemi pasur parasysh Hipotezën e përgjithshme e cila ka për objekt studimi reformat në shkollat e Kosovë për gjatë decenijeve të kaluara, sepse arsimimi në vendin tonë kishte nevojë për reforma të tilla.

Këtu do ta kemi parasysh si kanë ndikuar në zhvillimin e fëmijëve parashkollor cilësia e kopshtit, klasa dhe karakteristikat e edukatorëve. Kemi pasur parasysh edhe ndikimin socio-ekonomik, cilësinë e klasëve të mësimit dhe nivelin e arsimimit të edukatorëve. Siç edhe kemi pritur, fëmijët e në klasët me edukatorë më të përgatitur kanë aftësi më të mëdha dhe janë më të përgatitur për shkollë.

Është përdorur edhe metoda e veçantë me anë të së cilës i kam hetuar rezultatet e arritura në edukimin parashkollor dhe fillor në Kosovë me theks të veçantë në shkollën fillore të Zhurit.

4. Metodatat e hulumtimit:

Natyra e këtij punimi na ka detyruar që ta përdorim sidomos metodën gojore përmes dialogjeve si me edukatorë edhe me menaxhmentin e tyre duke mos e lënë anash edhe bisedën me ish- nxenes. Nga ana tjetër është përdorur edhe metoda historike ku kemi hulumtuar në arkivat e ndryshme rreth zhvillimit të procesit arsimor dhe edukativ të një shkolle apo kopshti të caktuar. Edhe metoda krahasuese ka zënë vend të duhur në punimin tone. Këtu kemi vënë në paralele shkollën në Zhur, atë në Korishë dhe në Prizren me qëllim të krahasimit të cilësisë së arsimit në këto tri shkolla. Ajo e Prizrenit, siç edhe kemi pritur ka dalë më e mira, kurse ato të dy fshtreve të sipërpërmendur kanë dale më të dobëta, varsisht nga kualifikimit të mësuesve të kohës.

5. Rëndësia e punimit

Siç thash edhe më parë, edukimi është faktori kryesor i formimit të personalitetit të një individi, ndërkaq individët e formojnë një shoqëri. Numri i individëve të arsimuar është i madh në Kosovë, prandaj edhe shoqëria jonë është e ngritur shumë. Sot e kemi një shoqëri të formuar profesionalisht dhe moralisht. Ky përparim i shoqërisë sonë duhet të përparojë edhe më shumë dhe kurrë nuk duhet të ndalemi. Kujtoj që ky punim modest do të shërbej si një ndër modelet e përgatitjes së masterit për kandidatët tjerë, por sidomos ka rëndësi për veten time, sepse falë kësaj pune unë kam arritur të fitoj kulture të gjërë në këtë fushë dhe të përgatitem teorikisht.

Në fund mund të konstatoj se falë këtij punimi unë e kam përvetësuar metodologjinë e punës shkencore e cila më mundëson që në të ardhmen t'i çoj edhe mëtej hulumtimet e mia si tezën e doktorates edhe të punimeve eventuale shkencore.

6. Struktura e punimit

Struktura e punimit do të duket si vijon:

Abstrakti, Përmbajtja, Parathënie, Kapitulli 1, Hyrje, **Pjesa e parë** : Fillet e arsimit në Zhur, Veprimtaria ndër vite e shkollës fillore në Zhur dhe menaxhimi i sajë, Zhvillimi i procesit mësimor, Arsimi fillor, Kuadri edukativ, organet e shkollës dhe këshilli I arsimtarëve, Shpërndarja e nxënësve si process I paevirueshëm, Mjedisi shkollor, **Pjesa e dytë** : Fillet e edukimit parashkollor në Zhur, Pashkëpunimi i shkollës me prindër, Organizimi I aktiviteteve

shkollore, Të drejtat dhe detyrat e fëmijës, Të drejtat dhe detyrat e e dukatorit, Të drejtat dhe detyrat e prindit, Lista e teksteve dhe mjeteve edukativo arsimore që përdoren aktualisht gjatë punës në kopsht, Mjetet didaktike, Programet sipas grupmoshave, Planifikimi mësimor dhe metodat, Faktorët kryesorë që ndikojnë në përgatitjen e fëmijëve parashkollorë, Institucionet edukative, Niveli i arsimimit të prindërve, Puna me fëmijët e moshës 1-3 vjeç, Puna me fëmijët e moshës 3-6 vjeç, Realizimi i programit përgatitor parashkollor, Bashkëpunimi me rrethin shoqëror, Përsosja profesionale e kuadrit arsimot, Realizimi I punës sociale, **Pjesa e tretë** : Nga teoria në praktikë, Zhvillimi kognitiv, social, emocional, motorik, gjuhësor, matematikor, Hospitimi im në kopshtin e fëmijëve, Plani, programi dhe ditari i edukimit parashkollor, Njësit mësimore.

7. Përfundim

Në përfundim I kemi sistemuar të gjitha detyrat e parashtruara në hyrje, të arriturat si dhe gjithë çka ka mbetur për t'u bërë nga hulumtuesit tjerë të kësaj fushe kaq me rëndësi të arsimit në Zhurë dhe vendet tjera në Kosovë.

8. Bibliografia

Në bibliografi janë paraqitur në detaje referencat e cituara si dhe ato të konsultuara dhe nganjë herë të përfolura. Është detyrë e hulumtuesëve tjerë që ta çojnë edhe më përpara bibliografinë e duher të kësaj fushe mbi arsimimin në institucionet parashkollore por edhe atyre të shkollave fillore.

PJESA E PARË

1.1 Fillet e arsimit në Zhur

Fillet e arsimit në Zhur janë mjaftë të hershme dhe deri më sot, me dijen time, nuk është marrë parasysh nga askush, prandaj kam pasur privilegjin që ta hulumtoj zhvillimin e arsimit fillor në këtë fshat, duke filluar nga ditët më të hershm. Fillet e deri më sot. Kam shkruar për historikun e shkollës fillore, për nxënësit dhe mësuesit e parë, për kushtet e punës, peripecitë e nxënësve dhe mësuesëve, për lokalet mësimore, librat, kuzhinën e atëhershme, kujdesin e popullatës ndaj shkollës që e kishin dëshiruar kaq shumë, por jam ndalur te formimi i kopshtit të fëmijëve më 1982, sot vetëm viti para fillor, deri në ditët e sotme.

Zanafillën e arsimit në Zhurë i hasim që nga Perandoria Osmane. Një zhurjan i ri, i quajtur Balë Muja, i cili gjatë disa viteve ishte edukuar në Stamboll për tu rikthyer në vendlindjen e tij me një qëllim dhe një ide: arsimimin e bashkëfshatarëve të vetë. Në fillim, ai hapi Mektebin, ku nxënësit përvetësonin shkrim-leximin në gjuhën turke. Këta njerëz arritën të jenë hoxhallarë të këtij rrethi dhe ata që përhapnin njohuri elementare në aspektin verbal në baza kuranore e për lutje në xhami, njëherit konsideroheshin si përhapësit e fesë islame².

Falë kërkërkësave të shumta për hapjen e shkollave turke në rrethin e Prizrenit, qeveria osmane e kohës hapi shkollën e parë publike Ruzhdije në vitin 1892, ku mësimet i mbanin hoxhallarët përparimtarë të kësaj treve. Me përpjekjet e hoxhallarëve të arsimuar një vit më vonë, në vitin 1893 themelohet Këshilli Arsimor si organ më i lartë arsimor³. Me hapjen e shkollave publike nëpër fshatrat më të mëdha, fëmijëve u jepet mundësia për ta vijuar këtë shkollë sidomos ata që më parë kishin përvetësuar alfabetin arab dhe turk. Edhe këto mësimet i organizonin dhe i mbanin hoxhallarët me që edhe ishin ndër njohësit më të mirë të gjuhës arabe dhe turke. Në fillim ata mësimin e organizonin në objektet e xhamive e sidomos jashtë kohës kur bëheshin ceremonitë e lutjeve. Më vonë duke u shtuar numri i vijuesve shtohet nevoja për një lokal të posaçëm mësimor,

²REXHEPAGIQ, Jashar, *Kultura islamo-persiane dhe ndikimi I saj tek ne, Prishtinë, 1970*

³ Rexhepagiq, Jashar, *po aty*

prandaj edhe u ngrit një objekt i tillë. Mësimi zhvillohej në kushte mjaftë të vështira, pa orendi mësimore . Mësojtorja ishte thjesht si një dhomë shtëpi⁴.

Periudha e sundimit otoman mbi popullaten shqiptare të Kosovës zgjati deri më 1912, kur tërhiqet ushtria turke, për t'ia lëshuar vendin një okupuesi barbar- ushtisë sërbe.

Periudha e viteve 1912-1918 mbeti periudhë përpjekjesh për t'u çliruar nga prapambeturia pesëshkullore turke. Vala tjetër okupuese permbysi çdo përparim të arritur gjatë okupimit osman, sado i pakët të ketë qenë ai.

Gjatë periudhës së Luftës së Parë Botërore, në vitet 1914-1918, nuk veproi asnjë shkollë, kurse më pas mbarimin esaj në vitin 1918 në Zhur hapet shkolla e parë katërklasëshe sërbe, edhe përkundër faktit se nuk jetonte asnjë serb në këtë fshat. Në këtë vit shkollor mësimet i ndjeknin 80 shqiptarë dhe 7 të tjerë që supozohet të kenë qenë të nacionalitetit rom⁵. Nga viti në vit numri i vijuesve vjen e shtohet, kështu që më 1923 mësimet i ndjeknin mbi 100 nxënës të rregullt, megjithë atë ata tash nuk paraqiten si shqiptarë, por si myslimanë⁶. Në vitin 1938 në Zhur vijnë mësimet vetëm 48 nxënës të rregullt. Në vitin shkollor 1936/37 ishin të regjistruar 156. Në mungesë të lokalit përkatës, mësimet zhvilloheshin në objekte të ndryshme shoqerore e private dhe në kushte mjaftë të vështira e të papërshtatshme. Aty mungonin edhe mjetet më elementare për punë si bankat, karrigat, tabelat , tekstet mesimore etj. Ky shkollim me mësim në gjuhën sërbe e me shkrim cirilik zgjati deri në vitin 1941 kur edhe shpertheu Lufta e Dytë Botërore⁷.

Pas përfundimit të kësaj lufte botërore, edukimi dhe arsimimi , gjatë periudhës së komunizmit, nisët nga parimet e shkruara kushtetutare. Në zhvillimin e arsimit dhe të shkollimit të shqiptarëve pas luftës në anën e Prizrenit, rol vendimtar kishin intelektualët dhe arsime dashësit e shkollës shqipe. Në këtë mënyrë për nevojat e vendit dhe për shkak të propagandës sistemore, zhvillimi i arsimit dhe shkollës shqipe mori hov të konsiderueshëm. Në atë periudhë Aleksandë Xhuvani kishte porositur: « hapni sa më shumë shkolla për të vegjël e të rinj, nuk prishë punë që tani për tani nuk keni mësues të kualifikuar për të dhënë lëndë të ndryshme », si matematikë, gjeografi, histori, etj. Mjafton që ato shkolla të jenë embrione të arsimit për ta luftuar kështu

⁴ Rexhepagiq, Jashar, *Po aty*

⁵ Rexhepagiq, Jashar, *Zhvillimi i shkollave deri në vitin 1918*

⁶ Rexhepagiq, Jashar, *Po aty*

⁷ *Hapja e shkollave shqipe në Kosovë, Arkivi I Kosovës*

alfabetizmin e për të mësuar gjuhën amtare. Shpejt do të vijë koha kur në shkollat tuaja do të keni mësues të aftë për të gjitha lëndët mësimore, sepse populli kosovar është shumë i zgjuar dhe i talentuar »⁸.

Shqiptarët e sidomos fshatarësia ishte në pozitë shumë më të palakmueshme, sepse analfabetizmi arrinte mbi 95% .Nëpër fshatra numri i intelektualëve apo edhe i atyre që dinin shkrim dhe lexim ishte i pakët. Përparësi e madhe ishte kur ndokush dinte sa për të lexuar një letër. E gjitha kjo pasojë e prapambetorisë të popullit shqiptar ishte e lidhur ngushtë me situatën e krijuar politike në mes dy Luftërave Botërore. Vitet e para të pasluftës, e sidomos vitet 1945-1948 përbëjnë pikënisjen e parë të një përpjekje të mirëfilltë në kahje të zhvillimit të përgjithshëm popullor, kryesisht në baza vullnetare të popullit shqiptar, i cili duke kuptuar rolin e arsimit nuk kursente mundin intelektual e material për t'i ndihmuar shkollës e arsimit shqip në trevën e Prizrenit⁹.

Për një zhvillim të ngjarjeve të krijuara nga situata në situatë do të shohim në rrjedhat e mëvonshme të punimit, ku do të paraqiten faktet sipas viteve dhe dekadave, ndersa theks te veçante i kushtohet zhvillimit të arsimit në Zhur prej asaj kohe deri sot.

Arsimi dhe edukimi në gjuhën amtare prej vitit 1945 ishte faktori kryesor i ngritjes së vetëdijes kombëtare. Me themelimin e ciklit parashkollor më 1982, edukimit dhe arsimimit të fëmijëve i doli përpara mësimi shkollor fillor për ta plotësuar atë dhe për t'i ardhur në ndihmë formimit më të plotë arsimor. Ky nivel arsimor sa shkon e e përmirëson cilësinë e shkollimit fillor. Duke e parë që kjo parapërgatitje i dha frytet e veta të pritshëm në edukimin e fëmijëve, prindërit dhe shoqëria e rriti me kalimin kohës edhe planin dhe programin e këtij institucioni pedagogjik me peshë të madhe edukative.Fëmijtë me edukim parashkollor u treguan shumë më të aftë për ta vazhduar edukimin e mëtuftëshëm. Numri i edukatoreve u rrit siç u rrit edhe hapsira për t'i plotësuar kushtet e volitshme për punë. Sot cikli parashkollor në Zhur i plotëson të gjitha standardet e kërkuara, ndërkaq hapsira për lojë është e volitshme dhe ka kushte për punë dhe për lojë.

Për edukatorë të parë në Zhur ishin emëruar Zonja Igballe Cavdarbasha-Celina dhe dhe Zonja Arife Siçeva,të cilat konsiderohen si pishtarë të arsimit dhe edukimit Ato i bënë hapat e

⁸Hapja e shkollave shqipe në Kosovë, po aty

⁹Hapja eshkollave shqipe në Kosovë, po aty

parë të edukimit parashkollor në këtë vend. Iniciatore e hapjes së çerdhes në Zhur ka qenë zonja Arife Siçeca.

1.2 Veprimtaria ndër vite e shkollës fillore «Ramiz Sadiku » (tash « Dëshmorët e Zhurit ») në Zhur dhe menaxhimi i saj

Gjatë periudhës 23 vjeçare të ekzistimit të Jugosllavise së vjeter të gjitha vendet e banuara me popullsi shqiptare ishin më të pazhvilluarat dhe më të prapambeturat në çdo pikëpamje. Populli shqiptar ishte i zhveshur nga të gjitha të drejtat kombëtare. Shqiptarët nuk kishin shkolla, ente kulturore e arsimore, gazeta dhe tekste shkollore në gjuhën amtare¹⁰. Mirëpo, socializmi si sistem i ri nuk mund të ndërtohej dhe të zhvillohej në një vend me shkallë të ulët të kulturës e me një shkallë të lartë të analfabetizmit. Andaj, te ne, një nga obligimet kryesore ishte arsimimi i shtresave të gjera popullore duke përfshirë të gjitha nacionalitetet.

Të mësuarit e shkrim-leximit nga të gjitha strukturat popullore, ishte e një rëndësie të madhe për zhvillimin e mëtejëm të mardhënieve socialiste në përgjithësi. Shqiptarët edhe pse ishin në gjendje dhe nivel më të ulët në çdo aspekt, ata u gjendën në rradhët e pjesmarrësve më aktivë në të gjitha fazat e zhvillimit të sistemit arsimor. Pas çlirimit, paralelisht me rihapjen e shkollave serbe, u hapën edhe shkollat me mësim në gjuhën shqipe. Sipas nje dokumenti të arkivit të Prizrenit, shkollat e para shqipe u hapën në pjesën e dytë të vitit shkollor 1944/45¹¹.

Hapja e shkollave kishte probleme, kryesori ishte mundesa e kuadrit arsimor. Në Zhur në kohën e themelimit të shkollës së parë shqipe katërklasëshe më 1945, nuk kishte asnjë mësues për punë me mësim në gjuhën shqipe. Meqë nuk kam hasur në burime të shkruara, jam takuar me disa nxënës të asaj kohe, që kishin ktyer nga tri e kater klasë të mësimit në gjuhën serbe ndonëse shumë të moshuar, për t'i pyetur për atë kohë dhe atë mësim, ata më rrëfyan se me vullnetin e tyre dhe dëshirën e prindërve, vijuan më vonë mësimet në gjuhën shqipe edhe pse e kishin kryer të njejtën apo të njejtat klasë.

¹⁰ Arkivi I Prizrenit

¹¹ Arkivi I Prizrenit

1.3 Zhvillimi i proçesit mësimor

Shkolla fillore “ Ramiz Sadiku “ në Zhur, e cila ishte ndër të parat me mësim në gjuhën shqipe ndër fshatrat e trevës së Prizrenit filloi punën e saj edukatikoarsimore në vitin 1945¹².

Mësimi zhvillohej në kushte mjaft të vështira, por me kalimin e kohës, krahas përparimit të kushteve në punë, shtohet edhe numri i mësuesëve me kualifikime përkatëse. Në fillim punën mësimore e nisi vetëm një mësues me 23 nxënës, pa asnjë femër. Mirpo, me zhvillimin e gjithëmbarshtëm shoqëroro-ekonomik, u shtua interesimi dhe u krijuan kushtet për emancipimin e femrës fshatare.

Përkundër kushteve me të cilët ballafaqoheshin mësime dhënësit e kësaj shkolle, rezultatet e deritashme në arsimim dhe edukimin e brezit të ri ishin inkurajuese të cilët ishin arritur falë angazhimit të përbashkët të mësime dhënëseve, organit manaxhues dhe bashkepunimit të ndersjellë mes familjes dhe shkollës. Pë rezultatet e arritura dëshmojnë faktet se nga ky fshat kanë kryer me qindra nxënës shkollimin e mesëm, të lartë dhe atë superior, madje edhe atë postdiplomik e të doktoraturës. Sot Zhuri është krenar me numrin e intelektualëve.

Në anën tjetër, prindërit bënin përpjekje për përhapjen e idesë së arsimit, i cili ishte mjeti më i mirë për ta siguruar ardhmerinë. Në anën tjetër zhvillohej beteja për përvetësimin e njohurive sa më të gjera.

Ja, si e përshkruanin punën arsimore në vitet e pas Luftës së Dytë Botërore dhe përparimin e mëtejëm, një ndër mësuesit e asaj periudhe :

« Fillimi ka qenë i vështirë. Kemi qenë pa përgaditje pedagogjike. Para çdo ore të mësimit këshilloheshin kolegët se si duhet të vepronin gjatë orës së mësimit Këtu nxënësit i ndiqnin mësimet nëpër lokalet e xhamive. Ishin vetëm dy mësojëtoje me 96 nxënës, 6 prej të cilëve ishin femra. Pas një kohe të shkurtër kishim 200 nxënës djem e vajza. Cdo mësues punonte në dy turne për shkak të lokalit të ngushtë. Mungonin kushtet dhe mjetet elementare. Në këtë shkollë, që atëherë nuk kishte as emër, drejtori e kryente edhe funksionin e sekretarit, të arkëatarit dhe ç' ishte kryesorja ishte mësues. Nuk mund ta harroj kurrë vullnetin e fortë të arsimtarëve. Ata

¹²Arkivi I shkollës fillore në Zhur, Proçes verbali dhe ditari i vitit 1945

perveç punës së përditshme, para dhe pas dite, në mbrëmje udhëhiqnin nga një ose dy kurse analfabetike. Asnjëri nuk mungonte në aksione vullnetare që organizoheshin në fshat e më gjerë. Me përgatitjen e kuadrit arsimor me kualifikime përkatëse bëhej edhe furnizimi shkollës me literaturë profesionale. Literatura mundësonte dhe lehtësonte tejkalimin e vështërsive të më parshme dhe arritjet e rezultateve më të mira në punën arsimore. Gjatë procesit arsimor dhe veprimit pedagogjik me nxënës, mësimdhënësit praktikonin format e punës frontale, grupore dhe individuale. Ndërsa, metoda që më së shpeshti praktikoheshin, ishin monologu, dialogu, metoda ilustrative-demostruese, tekst metoda etj¹³.

Lëndët mësimore që mësoheshin nga klasa e I–IV, që nga viti 1945 sipas klasave kanë pasur pak ndryshime gjatë viteve në vijim.

Notimi i nxënësve ishte numerik që nga fillimi i shkollës së parë shqipe deri në vitin shkollor 1979/80 kur fillon të praktikohet edhe notimi përshkrues për disa lëndë të shkathtësive si lëndë e mesit shoqëror. Notimi përshkrues është praktikuar deri në vitin shkollor 1984/85 nga këto lëndë: Kulturë Figurative, Kulturë Muzikore, Edukatë Fizike dhe Shëndetsore, Bazat e Arsimit teknik, Amvisër. Notat numerike ishin : 1 (dobët), 2 (mjaftueshëm), 3 (mirë), 4 (shumë mirë), dhe 5 (shkëlqyeshëm), kurse notat përshkruese: A (plotësisht), B (kënaqshëm), C (joplotësisht).

Duhet cekur se që nga viti 1945 e deri në vitin shkollor 1958/59 nota numerike 2 konsiderohej si notë e dobët, kurse një vit më vonë nota 2 fuqizohet si notë positive, ndërkaq si notë e dobët konsiderohej 1 (njishi)¹⁴.

1.4 Arsimimi fillor

Trashëgimia e mëparshme e gjendjes së rëndë kulturore dhe arsimore në Zhur, para Luftës së Dytë Botërore, me një numër të madh të analfabetëve, bëri që autoritetet e atëhershëm të përqëndrohen në hapjen e shkollave, sigurimin e lokalit shkollor dhe kuadrit arsimor e pastaj ta merren me organizimin e kurseve analfabetike dhe arsimimin e të rriturve.

¹³ *Plan-program i shkollës fillore në Zhur I vitit 1945*

¹⁴ *Ditari mësimi I vitit 1958*

Organizimi i kurseve analfabetike kryesisht përqëndrohej në zhvillimin dhe zotërimin e shkathtësisë së lexim-shkrimit në mënyrë që individi të hyjë në rrjedhat elementare shoqërore dhe kulturore. Njëherit, përvetësimi i shkrimleximit ishte parakusht për fitimin e dijes, ishte bazë për arsimin personal të çdo njeriu.

Që nga viti 1945, me hapjen e parë të shkollës shqipe në Zhur, filloi edhe aktiviteti i ndërsjellë në mes shkollës dhe organeve lokale për organizimin e kurseve për zhdukjen e analfabetizmit, që në popull njihej si vijim i shkollës së natës. Viteve të para të këtij lloj organizimi nuk kishte ndonjë programim dhe organizim të veçantë, por konsiderohej si aktivitet i përgjithshëm popullor ku ishin përfshirë të rinjtë dhe të rejtat e fshatit. Në këto shkolla, përveç kursit të lexim-shkrimit organizoheshin edhe kurse të shëndësisë dhe kuzhinierisë¹⁵. Duke pasur parasysh se një numër i madh i të rinjëve të fshatit, për shkaqe të përmendura më parë, në vitet e para të pasluftës nuk kishin vijuar mësimet. Në kuadër të shkollës përveç mësimet të rregullt, organizohej edhe mësimi me të rritur me programme të reduktuara mësimore. Për arsimimin e të rriturve që nga viti shkollor 1958/59, në shkollën e Zhurit filloi për herë të parë të përgaditen kandidatët për provime kualifikuese, që ndër popull njihen si kryerje e shkollimit fillor përmes provimeve private. Pas kryerjes së provimeve private me sukses, shumë kandidatë nga i gjithë rrethi i Prizrenit, në fund merrnin deftesat përkatëse. Sipas procesverbaleve të kohës mund të vërehet se numri më i madh i kandidatëve kishin të kryer shkollën fillore katërklasëshe, ndërkaq qëllimi i tyre ishte që të kryenin shkollimin e plotë fillore për arsye se sipas akteve ligjore të pas viteve të 60, ky shkollim ishte kusht i punësimit në ndonjë organizatë¹⁶. Nga viti në vit numri i kandidatëve shtohej dukshëm dhe vijuesit gravitonin nga vende të ndryshëm.

Kjo mënyrë e organizimit nuk mund të vlerësohej si një përgaditje apo aftësim i mirëfilltë profesional, por qëllimi ishte furnizimi i njerzëve me dëftesa të shkollimit fillor si një ndër kushtet e lehtësuara për përparësi në punësim.

Aktivitetet e lira mësimore organizoheshin dhe realizoheshin paralelisht me lëndët mësimore, ato konceptoheshin sipas dëshirës, interesit, prirjes dhe suksesit të treguar në mësim. Ishin pjesë

¹⁵ Arkivi i shkollës në Zhur, Proçes verbal I vitit 1957

¹⁶ Arkivi i shkollës në vitit 1960

integrale e programit vjetor të punës shkollore dhe planeve të veçanta individuale apo të mësimdhënësve.

Përmes aktiviteteve të lira realizoheshin qëllimet dhe detyrat edukativo-arsimore me fushëveprime të përcaktuara. Mirëpo, aktivitetet e lira mësimore si tërësi dallonin nga mënyra e planifikimit, programimit dhe mënyrës së realizimit, meqë ndryshonte edhe përmbajtja e punës, varësisht nga lënda për të cilën ishin përcaktuar nxënësit.

Në kuadër të gjuhës dhe letërsisë shqiptare vepronte grupi i recituesve dhe grupi dramatik “Drita”. Këto aktivitetet e udhëhiqënin arsimtarët e gjuhës dhe letërsisë shqipe. Këto grupe deri më tani kanë arritur rezultate të lakmueshme. Grupi letrar

“Drita” me krijuesit e rinjë kanë marrë pjesë në konkurse të ndryshme letrare. Bëhej edhe pasurimi i rregullt i gazetës së murit në shkollë, prezentimi me punime në gara të ndryshme në nivel komunal, paraqitja dhe publikimi i punimeve në gazeta e revista të ndryshme për fëmijë.

Aktivitetet e lira mësimore në shkollë zhvilloheshin në seksione të ndryshme:

Seksioni letrar, gjeografët e rinjë, biologët e rinjë, matematikanet e rinjë etj.

Këto seksione çdo herë kanë qenë pjesëmarrës në gara të ndryshme shkollore, komunale e rajonale. Atribute të veçanta për organizimin dhe realizimin e aktiviteteve të lira të nxënësve kanë edhe kualifikimet përkatëse lëndore dhe përsosshmëria permanente profesionale e kuadrit arsimor. Aktivitetet e lira të nxënësve, si ato mësimore dhe jashtë mësimore, organizohen në bazë të parimeve pedagogjike, sipas deklarimeve dhe interesimit personal të nxënësve, gjithënjë duke u bazuar në aftësitë dhe mundësitë e nxënësve, prej nga varej edhe shkalla e rezultateve dhe të përparimit.

Këto aktivitete përbëjnë një fushëveprim të gjërë me vlera të mëdha edukativoarsimore. Ato ishin themel i shprehjes së lirë të nxënësve dhe prirjes personale të tyre kur vinin në shprehje zbulimi i talenteve të rinjë që nga moshën shkollore. Edhe përkundër kushteve të vështira, një numër i konsiderueshëm i nxënësve ishin të angazhuar në realizimin dhe begatimin e një jete kulturore, artistike dhe plotësimin e ndjenjave shpirtërore të jetës së tyre. Me angazhimin e ndërsjellë të nxënësve dhe arsimtarëve të shkollës nga fushat e ndryshme, janë arritur rezultate të lakmueshme.

Për aktivitete të dendura duhet veçuar grupin dramatik me realizime dramatike e skeqe humoristike nga aktorët e rinje shkollorë, ata realizonin gati çdo vit nga një projekt dramatik. Rezultate mjaftë të mira janë arritur edhe në lëmin e kulturës muzikore, me paraqitje të shumta para publikut shkollor dhe qytetarëve të fshatit me pjesëmarrje në gara të ndryshme të nivelit komunal e rajonal, shumë herë edhe kanë fituar mirënjohje të ndryshme. Kështu është pasuruar jeta kulturo-zbavitese në shkollë dhe fshat, sepse nxënësit e kësaj shkolle dhe arsimtarët, që ishin adhures të kultures muzikore, ishin edhe themelues të shoqërisë Kulturo-Artistike “ Besa“ në Zhur, ku ishin inkuadruar edhe shumë të rinjë të fshatit.

Në kuadër të veprimtarisë edukativo-arsimore me nxënës, përpos punës së rregullt mësimore dhe formave tjera të punës, zhvillohej edhe një veprimtari nëpërmjet aktiviteteve shoqërore të nxënësve, siç është Lidhja e Rinisë Shkollore. Këto aktivitete organizoheshin dhe realizoheshin në bazë të parimeve që rridhnin nga angazhimet shoqërore, plotësimi i interesimit, prirjeve individuale, pavarësimi, krijimtaria, loja e argetimi nga fushat e ndryshme shoqërore. Në historikun e zhvillimit të shkollave të sistemit politik të kaluar. Këto organizata luajnë rolin udhëheqës të të gjitha aktiviteteve të nxënësve në shkolla. Këto aktiviteteorganizoheshin në përputhje me moshën e nxënësve. Detyrat dhe aktivitetet përmbajtësore mbështeten në programet shkollore dhe në rregulloret e programet të Lidhjes së Rinisë Shkollore. Aktiviteti i Rinisë Shkollore përbënë një pjesë të programit edukativo-arsimor të shkollës. Veprimtaritë e këtyre i menaxhonte kryesia e zgjedhur në bazë të përfaqësuesve të paraleleve. Qëllimi i veprimit të këtyre organizatave të nxënësve në shkolla ishte që të realizohet synimi i përgjithshëm i arsimit, për të kontribuar në formimin komplet të personalitetit human, krijues, punues, dhe aktiv . Detyrat që rrjedhin nga programet e veçanta të këtyre dy organizatave janë të shumta, por po i permendim disa nga to:¹⁷

- qëndrimi ndaj punës, diciplinës dhe formimi i shprehive ;
- zhvillimi i dashurisë së ndërsjellë mes njerëzve ;
- zhvillimi i ndjenjës për bashkepunim ;
- zhvillimi i vetëiniciativës në punë dhe organizimi sa me racional i kohës së lirë ;
- kultivimi i traditave, kulturës, dokeve dhe zakoneve kombëtare etj.

¹⁷(Arkivi I shkollës, Raporti vjetor i punës së shkollës fillore, 1990)

Në kuadër të kësaj organizate të nxënësve vepro te edhe organizata e karakterit humanitar e njohur si organizata e të rinjëve të Kryqit të Kuq, e bazuar kryesisht në ngritjen e nivelit të kulturës shëndëtesore, në kultivimin e ndjenjave reciproke në frymën e humanizmit dhe solidaritetit. Njoftimi i nxënësve me detyrat e Kryqit të Kuq për zbutjen e pasojave të paraqitura , zhvillimi i miqësisë dhe mirëkuptimit ndërmjet të rinjëve anë e kënd të botes, mbi higjienën personale, ndihmave ndaj të moshuarëve, të semureve dhe të vobektëve, etj.

Nga viti shkollor 1990/91, Lidhja e Rinisë Shkollore transformohet në një organizatë të vetme e njohur si Lidhja e fëmijeve, e cila nuk ndryshon për nga permbajta dhe qëllimi nga ato të mëparshmet.

Biblioteka

Biblioteka shkollore si një ndër kushtet ndihmës i procesit të rregullt mësimor ishte menduar me kohë për të filluar veprimtarinë e saj të mirëfilltë, por në mungesë të lokalit , ajo mbeti e pa organizuar. Mirëpo, me kalimin e kohës gjithënjë e me shumë ndihej nevoja e furnizimit të nxënësve me lekturë shkollore dhe pasurimit të tyre me njohuri dhe shprehi në shfrytëzimin eliteraturës plotësuese. Në prag të vitit shkollor 1969/70, ishte themeluar biblioteka shkollore me sigurimin e mbi 500 ekzemplarëve të lekturës shkollore, literaturës profesionale për mësimdhënës e vepra tjera historike nga arti e kultura. Biblioteka në gjiun e vet e kishte edhe shtypin e rregullt ditor, gazeta e revista periodike e sidomos ato që trajtonin çështjet arsimore. Për punë në bibliotekë, ishin angazhuar kryesisht arsimtarët e gjuhës dhe letërsisë shqipe. Deri në vitin 1992 biblioteka pasurohej rregullisht me literaturë të re dhe kishte arritur fondin e saj të përgjithshëm në 2969 tituj. Me transferimin e bibliotekës së fshatit në lokalet e bibliotekës së shkollës së re, numri I titujve u rritë shumë. Ajo sot mund të merret për një bibliotekë të pasur. Salla e madhe dhe moderne del të jetë funksionale ku nxënës, mësimdhënës dhe qytetarë jo vetëm të fshatit të fitojnë aty njohuri të reja¹⁸.

Mbrojtja dhe përparimi i shëndetit të nxënësve është një çështje shumë e rëndësishme për institucionet edukativo-arsimore . Një ndër faktorët që kanë rol në mbrojtjen dhe përparimin e shëndetit të fëmijëve, janë institucionet e organizuara mjeksore, ruajta e ambientit, higjiena,

¹⁸ Arkivi shkollës në Zhur, Biblioteka, 1992

ushqimi etj. Organizimi dhe funksionimi i rregullt i kuzhinës shkollore për furnizimin e nxënësve me ushqim ka rol të rëndësishëm në zhvillimin normal të të gjitha potencialeve psiko-fizike dhe sociale të nxënësve gjatë procesit mësimor. Kjo mënyrë e organizimit dhe furnizimit të nxënësve së paku me një racion plotësues, në shkollën e Zhurit deri vonë nuk ishte organizuar për arsye të mungesës së lokalit për kuzhinë. Me ndërtimin e objektit të ri shkollor u krijuan kushtet për organizimin dhe funksionimin e kuzhinës shkollore. Racioni plotësues që i jipej nxënësve ishte organizuar në mënyrë të ndryshme. Deri vonë kjo mënyrë e të ushqyerit ishte e rregullt, kurse kohëve të fundit nxënësit furnizohen me racion plotësues, ushqim të thatë. Marrja e racionit plotësues është një ndihmesë e mirë për nxënësit të cilët ndikon në shtimin e aftësisë për punë, dukshëm ndikon në përvetësimin e njohurive, shprehive dhe shkathtësive të nxënësve, mbron qëndrueshmërinë, mban vitalitetin dhe koncentrimin psiqik të nxënësve. Po ashtu dukshëm reflektohet edhe në shtimin e kujdesit dhe interesimit për punë aktive gjatë procesit mësimor.

Gjatë veprimtarisë edukativo-arsimore 72 vjeçare, shkolla fillore në Zhur, si rezultat i punës së mirëfilltë të kuadrit arsimor, bashkëpunimit të ndersjellë të familjes dhe shkollës, dolën shumë nxënës të dalluar. Një numër i konsiderueshëm që fituan bazat e arsimimit në këtë shkollë, vazhduan shkollimin e mëtutejshëm në fusha të ndryshme ku edhe arritën rezultate të lakmueshme në shkencë, kulturë, arsim, shëndetësi, ekonomi, teknikë, eteknologji e çka mos tjetër.

1.5 Kuadri edukativ, organet e shkollës dhe këshilli arsimtarëve

Mësuesit janë faktorët bazikë dhe më të rëndësishëm në organizimin dhe realizimin e detyrave edukative-arsimore.

Siç kemi cekur më lartë, gjatë Luftës së Dytë Botërore ishte ndërprerë procesi mësimor që më parë zhvillohej në gjuhën serbe. Krahas të gjitha prapambeturive shoqërore dhe ekonomike, në mungesë të madhe ishte edhe kuadri arsimor. Meqenëse fëmijët shqiptarë para Luftës së Dytë Botërore kishin kryer shkollimin fillor në gjuhën serbe, ata i rikthehen kualifikimeve që organizoheshin në formë të kurseve pedagogjike. Kur flitet për kuadrin arsimor sidomos në Zhur, mund të thuhet se në atë kohë nuk kishte asnjë kuadër të kualifikuar për punë mësimore.

Mirëpo, një e metë e tillë ishte e pranishme në tërë rrethinën e Prizrenit dhe në mungesë të kuadrit arsimor Organet e pushtetit mësuesit emëronin me dekreti nga viset e ndryshme , mirëpo në Prizren me rrethinë mësuesit vinin kryesisht nga Shqipëria dhe Maqedonia.

Në pranverë të vitit 1945 në Zhur, caktohet si mësues i parë Zylfo Qerimaj. Ky mësues përcolli gjeneratën e parë të klasës së parë me mësim në gjuhën amtare¹⁹.

Ndërkohë, me shtimin e nxënësve dhe në mungesë të kuadrit shqiptar, mësime të kombinuar detyroheshin të punonin në dy ndërresa me nga dy klasë me mësim të kombinuar.

Edhe pas viteve pesëdhjetë në Zhur fillojnë të kualifikohen kadro arsimore, por ato emërohen për të vepruar edhe në fshatra tjera.

Mësuesit, përpos që ishin të angazhuar gjatë tërë ditës me nxënës, ata udhëheqnin edhe shkollat e mbrëmjes me të rritur me qëllim të aftësimin me shkrim-lexim dhe për çrrënjosjen e analfabetizmit që kishte përfshirë gjithë Kosovën. Kadri arsimor që ishte i angazhuar në Zhur ishte kuadër i aftësuar për mësues përmes kurseve pedagogjike në Pejë, në Prizren , në Mitrovicë dhe në Shkup.

Kuadri arsimor në Zhur, me kalimin e kohës, shtohet dukshëm dhe bëhet gjithënjë me kualifikim përkatës. Zhurjanët i rrekën shkollimit duke u regjistruar në shkolla normale, shkolla të larta dhe më vonë nëpër fakultete.

Që nga themelimi i shkollës fillore në Zhur, ishin organizuar edhe organet qeverisëse . Aty ku numri i punëtorëve ishte i vogël ishin të ndërlidhura me organet kompetente të një shkolle tjetër.

Në Prizren, sipas të drejtave ligjore që nga viti 1945 fillon së ekzistuarit Këshilli I shkollës ku anëtarë ishin punëtorët arsimorë dhe përfaqësuesit e bashkësive shoqërore – politike, prindërit dhe qytetarët.

Pleqësia e shkollës ishte organi më i lartë qeverisës. Mënyra e zgjedhjes së anëtarëve, të drejtat dhe obligimet e tyre rregulloheshin me ligj dhe me statutin e shkollës, kurse mënyra e punës me rregulloren e punës të organeve qeverisëse të shkollës. Pleqësia e shkollës kishte përbërjen e saj

¹⁹ Arkivi i shkollës

me forum të zgjeruar e cila nxirrte vendime, përcillte dhe vlerësonte realizimin e tyre mbi çështjet e përgjithshme të organizimit dhe mirëvajtjes së shkollës, si për shembull²⁰:

- programin e zhvillimit mësimor,
- programin vjetor të shkollës,
- raportin vjetor të punës edukative- arsimore të shkollës,
- planin financiar dhe llogaritë periodike,
- planin e regjistrimit të nxënësve dhe
- shpalljen e konkursit për zgjedhje, emërimë, revokim dhe shkarkimin e organit punëdrejtues të parapara me statutin e shkollës.

Puna edukative-arsimore është veprimtari mjaft komplekse të cilës i duhet një menaxhim profesional. Organet profesionale patjetër duhet të marrin vendime të studiuara mirë dhe të verifikuara nga teoria, ligjshmëria dhe praktika pedagogjike.

Pra, organet profesionale të shkollës ishin:

- këshilli i arsimtarëve,
- këshilli i klasëve,
- aktivet profesionale dhe -kujdestari i klasës.

Këshilli i arsimtarëve - ishte organi më i lartë profesional dhe kishte për detyrë t'i kordinojë punët rreth përgatitjes, organizimit, përcjelljes dhe vlerësimit të realizimit të punës së gjithëmbarshme të shkollës. Këshillin e arsimtarëve e përbënin të gjithë mësimdhënësit e angazhuar në realizimin e detyrave edukative- arsimore. Këshillin e arsimtarëve e udhëhiqte drejtori i shkollës . Ky këshill e aprovonte planin vjetor të punës, ndanëte lëndët mësimore, caktonte kujdestarin e klasëve, analizonte suksesin, vijimin, diciplinën e nxënësve në çdo periudhë mësimore .Hartonte, aprovonte dhe realizonte programin e përsosshmërisë profesionale, shqyrtonte dhe aprovonte masat disiplinore ndaj nxënësve, etj. Këshilli i arsimtarëve, pleqësisë së shkollës i propozonte

²⁰ Arkivi i Shkollës, Proçes verbalet

nxënësit dhe arsimtarët për lavdata dhe mirënjohje. Mbledhjet e rregullta i mbanin çdo muaj, por edhe në gjysmëvjetor dhe në fund të vitit shkollor. Këshilli arsimtarëve mbante proces-verbalet e mbledhjeve.

Ndërkaq Këshilli i klasëve- merrej me këto çështje pedagogjike²¹:

- formonte klasat dhe paralelet në fillim të vitit shkollor,
- udhëhiqëte dokumentacionin pedagogjik të klasës, si librin amzës,ditarët e punës, dosjet e nxënësve , etj,
- hartonte planet dhe programet lëndore për klasë,
- përcillte realizimin e tyre,
- planifikonte punën plotësuese,
- bënte analizën e raportit të drejtorisë së shkollës,
- ndërmernte hapa konkrete në rast të lëshimeve apo gabimeve në punë me qëllim të përmirësimit,
- planifikonte dhe organizonte mbledhjet e prindërve,
- shqyrtonte suksesin e nxënësve,
- shqyrtonte edhe punën e arsimtarëve, etj.

Aktivitetet profesionale formoheshin nga mësimdhënësit e profilit të njejtë profesional dhe lëndëve të ngjajshme mësimore. Me që në këtë shkollë numri i mësimdhënësve që jipnin një lëndë ishte i vogël, prandaj aktivitetet profesionale ishin të formuar në bazë të afërsisë së lëndëve. Në këtë shkollë vepronin pesë aktive profesionale :

- aktivi profesional parashkollor,
- aktivi profesional i mësimit klasor,
- aktivi i gjuhës shqipe dhe gjuhës së huaj, -aktivi i matematikës dhe i lëndve mbi natyrën dhe -aktivi kulturo-shoqëror.

²¹ *Proces verbalet e shkollës*

Nga ana tjetër edhe kujdestari i klasës ishte organ individual pedagogjik, i cili udhëhiqte klasën, përkatësisht paralelën.

Në bazë të propozimit të drejtorit të shkollës, atë e caktonte këshilli i arsimtarëve. Për kujdestar klase caktohej arsimtari që jipte mësim në klasën e caktuar dhe që kishte përvojë pedagogjike për punë me nxënës, me prindër dhe arsimtarë. Detyrat e kujdestarit të klasës si udhëheqës pedagogjik i klasës, kishte për detyrë të njihëte dhe të ndihmonte zhvillimin psiko-fizik dhe moral të nxënësëve. Të zhvillojë shprehitë për punë, për sjellje korrekte dhe njerëzore. Këtë aktivitet, kujdestari i klasës e zhvillonte në orët e kujdestarit të klasës, kurse edukatori i ciklit parashkollor, gjatë tërë aktivitetit edukativ e arsimor.

Kujdestari i klasës ka për detyrë të mbajë dokumentacionin pedagogjik të klasës: amzën e klasës, ditarin e punës, dosjen e nxënësve, dëftesat, diplomat, vërtetimet, certifikatat, etj.

Mes tjerash, kujdestari i klasës kryente edhe disa aktivite tjera pedagogjike:

- ishte udhëheqës pedagogjik i klasës,
- koordinonte punën dhe ndikimin e faktorëve edukativë,
- mbante dokumentacionin e klasës,
- bashkëpunonte me shërbimin pedagogjik dhe psikologjik, -bashkëpunonte me prindërit e nxënësëve, etj.

1.6 SHPËRNDARJA E NXËNËSVE SI PROCES I PAEVITUESHËM

Nuk zgjati shumë vite prej hapjes së kopshti në Zhur kur filloi të zbrazet ai. Jo që mungonte interesimi, por njerëzit që punonin në diasporë i merrnin gratë dhe fëmijët e tyre. Kishte edhe arsye tjera. Pati filluar lëkundja e shtetit të përbashkët. Filluan luftërat dhe më vonë u copëtua Jugosllavija. Edhe në Kosovë ndodhi lufta. Prap njerëzit migruan bashkë me fëmijët. Në kopshte nuk kishte më shumë fëmijë, nuk investohej më. Kopshtet u degraduan. Puna u degradua. Shumë edukatore mbetën pa punë. Ambientet e kopshteve kishin marrë pamje të dhimbshme.

Sot kopshti i fëmijëve në Zhur ka pak fëmijë, ka dy grupe, por ai punon mire dhe fëmijëve iu ofrohet përgatitje solide. Përcillen plan-programet sipas kërkesave të MASHT-it. Kopshti vazhdon të bashkëpunoj me institucionet tjera.

Ka edhe disa fëmijë me aftësi të kufizuara ku edukatorët e përshtatin përmbajtjen e plan-programit sipas aftësive të tyre. Sa kam vërejtur unë, edhe pse thuhet se program përshtatet për ta, unë nuk kam parë se me ta organizohet diç e posaçme. Ata janë aty për ta kaluar kohën deri sa prindërit janë në punë. E kam të dëgjuar se këta fëmijë dërgohen në kopsht në mënyrë që familja të ketë kohë për t'i kryer punët e fushës dhe të shtëpisë, në ndërkohë edhe të pushojnë!?

Me fëmijë me nevoja të veçanta, jo vetëm në Zhur por edhe në Prizren ku kam pasur rastin të hulumtoj, nuk punohet me plane individuale. Kjo për arsye se të mungesës së arsimtarëve nëpër kopshte.

Në këtë kopsht, fëmijët arrijnë të zhvillojnë potencialet e tyre, të botës emocionale, aftësive e nevojave të tyre sigjithë edhe krijimin e shprehive të shëndosha.

Për fatin e fëmijëve të shkapërderdhur nëpër vendet perendimore nuk dimë shumë, por e kemi të dëgjuar se një numër i vijon mësimet plotësuese, ndërsa pjesa dërmuese mbeten pa mësimin gjuhës shqipe.

Disa hulumtime janë bërë lidhur me këtë dukuri dhe është konstatuar se faktorët kryesorë që e përcaktojnë mosvijimin e procesit mësimor janë këta:

- botëkuptimi tradicional i çështjes së arsimit dhe edukimit,
- mos prezenca e prindërve në rrethin familjar,
- mos prezenca e prindërve për të bashkëpunuar me shkollën dhe familjes,

- perspektiva e çështjes së punësimit,
- grupi i fëmijëve me të meta apo pengesa në zhvillimin psiko-fizik dhe -mos shfaqja e interesimit për shkollim.

Sigurisht se shkaqet e shkapërderdhjes së nxënësve në përmasa kaq të mëdha, veçmas kur është fjala për ata që shkollën e braktisinë për tu larguar nga atdheu nuk duhet të jetë preokupim dhe punë vetëm e subjektit arsimor, por për këtë dukuri duhet të mirren institucionet shtetërore dhe të ndërmirret një masë preventive për ndërprerjen e shkapërderdhjen e fëmijëve.

Pas luftave Ballkanike të viteve 90, arsimi shqip pësoj shumë. Në Kosovë shkollat u mbyllën. U hapën shkollat shtëpi, por edhe kjo nuk funksiononte. Si pasojë ishte ulëja e numrit të nxënësve. Ishin faktorë të ndryshëm që shkaktuan këtë pasojë mjaftë e ndieshme për ekzistencën e këtyre trojeve.

Rënëia e numrit të nxënësve në mënyrë drastike që nga ai vit filloi të vërehej shumë edhe me këtë dukuri në rritje shpesh menaxhuesit e shkollave gjatë diskutimeve me kolektivet e tyre i jipnin vetës shpresë se ky fenomen do të ndaloj e do të rritet numri i fëmijëve në parshkollor e në shkollë. Tash jemi para faktit të kryer, ku vitet e fundit çdo fillim viti shkollor dëgjojmë përmes mediaave për shuarje të paraleleve, për teprica teknologjike, zvogëlim i fondit të orëve, zvogëlim i punëtorëve teknikë, etj.

Arsyja një dhe e vetme, zvogëlimi i numrit të nxënësve ë regjistruar për klasën zero apo për klasën e parë

Tash vetëm 43% të nxënësve kanë sjellë dokumente për regjistrim. Shtrohet pyetja, ku janë të tjerët ?, ja përgjigjja

- mungesa e një materniteti,
- papunësia,
- jo stabiliteti politik,
- streset e ndryshme psikike,
- shpërngulja,

(Proçes verbalet e shkollës)

Trupi arsimor ballafaqehj me mungesë të nxënësve për shkak të – natalitetit të vogël, shpërnguljeve dhe migrimit.

Në këtë vit shkollor janë 70 nxënës më pak, për disa vjet shkolla do të mbyllet.

Ndër arsyenat tjera të rënies së numrit të nxënësve nëpër shkolla shqipe Është edhe ulja e cilësisë së punës edukative-arsimore, sepse kuadri po shpërngulej për kushte më të mira në qytet.

Kuvendet komunale nuk e kanë ngritur çështjen e rënies drastike të natalitetit dhe rrjedhimisht rënien e numrit të nxënësve , seriozisht deri tash. Mendoj që kjo çështje duhet të ngritet lart e të jetë kryeçështja e institucioneve tona lokale e regjionale, sepse nuk mund të neglizhohet rënia e natalitetit, mbyllja e shkollave, shpërnguljet. Argumenti për alarm sa vjen e rritet dhe më duket se alarmi ka filluar disa vite më here.Për rënien drastike të numrit të nxënësve e dëshmojnë të dhënat nga bashkëpunëtori profesional për arsim në komunën e Prizrenit ku gjatë vitit të kaluar shkollor numri është zvogëluar për 98 nxënës. Arsyet, gjendja sociale, nataliteti i ulët, papunësia, shtyrja e moshës për tu martuar, etj. Migrimi fshat-qytet, apo jashtë vendit, mungesa e paperspektivës.

1.7 Mjedisi shkollor

Organizimi dhe realizimi i punës mësimore dhe asaj jashtëmësimore varet plotësisht nga sigurimi i mjaftueshëm i hapësirës shkollore dhe përfshirja e plotë e fëmijëve të moshës shkollore dhe parashkollore. Në Zhur është vërejtur se shtimi demografik gjithënjë ka qenë në rritje, mirëpo hapësira shkollore nuk ishte në gjendje ta përcillëte në mënyrë të vazhdueshme shtimin e numrit të nxënësve²². Kështu vazhdoi puna në objektin e vjetër, ku kushtet nuk ishin të përrshtatshme për shkollim cilësor. Shkolla e vjetër nuk kishte as sallë për edukatë fizike, as kabinet lëndor, as bibliotekë, ndërkaq mësimi zhvillohej kryesisht në mbështetje të metodës tradicionale. Kjo metodë ishte fjala e gjallë e mësuesit.

Në pranverë të vitit 1988 u ndërtua objekti i ri shkollor i cili posedon pos mësojësoreve të nevojshme edhe mediatekë, bibliotekë, punëtori për nxënës, kuzhinë shkollore, sallë të arsimtarëve, zyra pune për menaxhementin e shkollës, kopshtin e shkollës, etj.

Prej këtij viti punohet mirë dhe sukseset e nxënësve ishin të dukshme.

Lokali parashkollor u ndërtua në qendër të fshatit, në trollin e shkollës së vjetër për shkak se fëmijët e kësaj moshe e kishin larg objekti i ri. Kopshti i fëmijëve i përbushë sot të gjitha standardet.

Pas ndërtimit të objektit të ri, shkollat fillojnë të pasurohen me inventar të ri. Mësojësoret pasurohen me banka, karriga dhe tavolina moderne si dhe zyret e punës dhe salla e arsimtarëve pasurohen me inventar të ri. Fjalës së gjallë të mësuesit dhe mjeteve ndihmëse i bashkangjiten edhe mjetet auditive, vizuele dhe audiovizuele.

Nga mjetet mësimore auditive për nevoja të procesit mësimor sigurohet magnetofon me shirit, kurse nga mjetet vizuele përdoren hartat, fotografitë, ilustrimet, diafilmi, diapozitivet, episkopi, flanelografi, diapjektori, grafoskopi. Më vonë sigurohen edhe disa mjete laboratorike për lëndën e kimisë, biologjisë dhe fizikës. Për lëndën e kulturesmuzikore sigurohen disa instrumenta në të cilët aftësoheshin nxënësit për ekzekutim, si në blokflaut, mandolinë, çifteli, harmonikë, violinë, etj.

²² *Proçes- verbalet*

Grupi i piktorëve të rinj, aktivitetin e vet e ka zhvilluar nga vitet e para të themelimit të shkollës së re, kështu nxënësit i mësonin fillet e vijave artistike. Ky grup për çdo vit shkollor ka hapur nga 5-7 ekspozita shkollore, është përkujdesur për rregullimin estetik të shkollës dhe mbledhjen e ruajtjen e vlerave popullore autoktone. Këtë aktivitet e kishte shtrirë në pjesëmarrje të rregullt të garave të ndryshme komunale dhe rajonale.

Përpos grupeve të lartpërmendura, me sukses janë organizuar edhe grupet sportive, si grupi i futbollit, I hendbollit, volejbollit dhe atletikës. Nën udhëheqjen e arsimtarëve të edukates fizike, këto grupe kanë organizuar gara shkollore, kanë qenë pjesëmarrës të rregullt në gara komunale. Sot, në saje të përparimit të mjeteve teknologjike, shkollat janë të pajisura me kompjuterë, internet, telefon fix dhe mobil.

Të shkollohesh sot është lehtë dhe privilegj, por k u janë fëmijët ?!

Fatkeqësisht, ata që janë këtu, nuk kanë motiv për të mësuar. I presin shokët e vetë?!

PJESA E DYTË

2.1 FILLET E EDUKIMIT PARASHKOLLOR NË ZHUR

Fshati Zhur është më i madhi në komunën e Prizrenit, prandaj duke parë nevojën për edukim parashkollor si formë e organizimit dhe aftësimit të fëmijëve për edukim dhe arsimim të mëtutjeshëm, autoritetet arsimore të asaj kohe e kishin parë të arsyeshme dhe kishin e ndier të nevojshme të hapet edhe në këtë fshat kopshti për fëmijë si në shumë fshatra tjerë të rrethit të Prizrenit dhe të mbarë Kosovës. Kështu, për herë të parë në Zhur, siç e cekëm edhe më herët, filloi nga puna, kopshti i fëmijeve në vitin 1982 në gjiun e shkollës fillore. Ndërkohë u ndërtua objekti I ri i kopshtit, I cili u nda fizikisht nga shkolla²³.

Në Kosovë, këto institucione dallohen me dy emertime sipas moshës së fëmijës: Cerdhe quhet për moshën e fëmijëve prej 0-3 vjeç, kurse kopsht quhet për fëmijët prej moshës moshës 3-6 vjeç. Nëpër shkolla fillore janë të hapura edhe klasa parafillore që esencialisht është e njejtë me kopshtin. është përgatitje për klasë të pare.

Kopshti është “ institucioni parashkollor arsimor për fëmijët që ka për detyrë të kryej edukimin shoqëror të fëmijët e moshës prej 3-6 vjet, të siguroj zhvillim të rregullt fizik e mendor, t’u jap elementet e para të edukatës estetike, t’i pajisë me vetitë elementare të moralit, si dhe t’i përgatis për të hyrë në shkollë fillore (Osmani,2006, cituar nga Majlinda Gjelaç)

Kur them kopsht, e kam parasysh që seksioni i çerdhes nëpër fshatra nuk ka ekzistuar fare, sepse nëpër fshatra të dërgohet një fëmijë 0- 3 vjeç jashtë familjes konsiderohej si gjest jo human.

Nëpër qytete ishte ndryshe. Nënatin punonin dhe ishin të shtrenguara t’i dërgojnë fëmijët në përkujdesjen e edukatoreve. Kur dikush ishte në shtëpi, si një gjyshe, një motër apo hallë, qoftë edhe përkohësisht, fëmija mbetej në shtëpi. Ishte “gjynah” të maltretohej fëmija i vogël.

Fillimisht, interesimi nga ana e prindërve , për regjistrimin e fëmijëve nga mosha 3 vjeçare në degën e kopshtit ishte i madh. Ndodhte shpesh mos të ketë vend për çdo fëmijë. Tash nuk është ashtu! Pse ?, do ta shohim më vonë.

²³ Arkivi i shkollës, Plan- programet dhe njësitë mësimore për çdo muaj

Me rastin e regjistrimit, prindërit nënshkruajnë kontratën e marrëveshjes me kopshtin. Gjithashtu prindërit njoftohen edhe me rregulloren e kopshtit si dhe pajisjen me informatorin e kopshtit që përmban shënime për kalendarin shkollor, planprogramet, orarin e mësimi si dhe materialin e nevojshëm që duhet të ketë secili fëmijë. Me rastin e regjistrimit, prindi duhet të plotësojë pyetësozin që përmban informacione për fëmijun. Të gjitha të dhënat për fëmijun janë konfidenciale. Me këtë rast bëhet një marrëveshje në mes të familjes dhe menaxhmentit, prej kah rrjedhin këto obligime:

Është detyrë e prindërve që:

- ta sjellin fëmijën në shkollë,
- të vijnë ta marrin fëmijën në kohë të caktuar,
- të merr pjesë në mësim kur të kenë mundësi,
- të veshin fëmijën siç e kërkon koha dhe rasti,
- të informojë edukatorët për çdo shqetësim që kemi për ta,
- të merr pjesë në mbledhjet vendimarrëse dhe të jep mendimet e veta,
- t'i paguaj obligimet e fëmijut për kopsht dhe të respektojë rregullën e kopshtit.

Është detyrë e personelit mësimor që:

- të trajtojë çdo fëmijë si një individ,
- të jenë në dispozicion të bisedojë me prindin kur ta sjell fëmijën ose kur ta merr atë,
- të organizojë takime informative për prindër,
- të sigurojë fshehtësinë e informacionit,
- të krijojë atmosferë të këndshme për fëmijë,
- të organizojë aktivitete të ndryshme dhe të përshtatshme për moshën e fëmijëve,
- të informojë rregullisht për progresin e fëmijës,

- të ju dërgojë informacion në shtëpi kur fëmija është i sëmurë apo i aksidentuar lehtë.

2.2 Bashkëpunimi i shkollës me prindër

Si gjithë edhe sot, familja ishte institucioni shoqëror në miniaturë ku organizohej dhe zhvillohej edukimi i fëmijëve. Edhe pse në mesin e shumë familjeve shqiptare ende dominon tipi patriarkal, ajo mbetet gurethemeli i edukatës ku fëmija bashkë me hapat e parë dhe fjalët e para në gjuhën e nënës, mëson spontanisht për botën që e rrethon dhe rrethin shoqëror ku ai jeton. Nga lidhshmëria e natyrshme e anëtarëve të familjes dhe zhvillimit të motivit amnor, ata i bashkon dashuria, nderi, besimi reciprok dhe shumëçka tjetër.

Familja fshatare e Zhurit çdo herë ka ditur t'i çmoj vlerat positive dhe përparimtare të saj, andaj ajo ka ditur ta ruaj edhe epitetin esencial të traditës autoktone.

Familja si faktor i bashkëpunimit të ndërsjellë me shkollën, konsiderohet si domosdoshmeri e kohës për lehtësimin e qëllimit të edukimit dhe arsimimit të fëmijeve. Familja dhe kopshti në Zhur kanë qenë dy faktorë ku bashkëpunimi është zhvilluar pa ndërmjetësimin e ndonjë faktori tjetër deri në fillim të vitit shkollor 1982/83, kur edhe filloi të punoi paralelja e kopshtit të fëmijëve ose klasa e fëmijëve parashkollorë. Me organizimin e edukimit parashkollor shtohet ndieshëm ndihmesa ndërmjetësuese në përgaditjen e fëmijëve për arsimimin fillor. Prandaj, nëse dëshirohet që veprimtaria edukativo-arimore të kuruzohet me suksese, atëherë duhet çmuar aktivizimin e vazhdueshëm të “ trekëndeshit didaktik” (shkollë - nxënës-prindë) dhe anasjelltas. Veprimi i drejtë i prindërve në familje reflektohet me ndikim pozitivin të fëmijëve, në mënyrë që ata të fitojnë shprehje edukative familjare si gjithë edhe kulturore dhe punuese të cilat e shtojnë edhe më tej zhvillim edukativ e arsimor në shkollë dhe jashtë saj.

Përparimi i punës së përbashkët të familjes dhe shkollës varet në një masë të madhe nga zbatimi i principit të “ Fitback-ut” (informata rikthyese) mes edukatorit dhe prindërve. Ky parim ka të bëjë me zhvillimin e fëmijës dhe me njohjen e kushteve kulturore, arsimore, sociale dhe morale në të cilat jeton dhe zhvillohet fëmija që nga lindja. Ndërsa, arsimtari me këtë kontakt ka mundësi ta njohë më mirë fëmijën përmes bisedave me prindin në shkollë.

Sipas punëtorëve socialë, prindërit duhet ta kenë të qartë se edukimi i fëmijëve varet nga angazhimi i përbashkët të prindit dhe mësuesit. Njohëja e fëmijëve dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre dhe mësuesëve duhet të arrihenë radhë të parë përmes komunikimit.

Këmbimi i informative dhe ideve mund të jetë i frytshëm nëse ato çmohen dhe zbatohen drejtë. Roli i prindit në organizimin e edukimit dhe arsimimit në shkollë dhe kopsht është i pa zëvendësueshëm vetëm atëherë kur ai konsiderohet si faktor me ndikim nëpërmjet organeve prindore, qofshin ato të paraleles, klasës apo shkollës. Organet prindore realizohen nëpërmjet formimit të Këshillit të prindërve. Këshillin e prindërve e përbëjnë prindërit e nxënësve, të cilin e menaxhon Këshilli koordinues i përbërë prej tre antaresh. Këshillin e prindërve të kopshtit e përbëjnë përfaqësuesit e Këshillit të prindërve të çdo grupi të cilin e udhëheq Këshilli prej tre anëtarëve. Numri i anëtarëve të Këshillit të prindërve të nxënësve të grupit varet nga numri i grupeve, meqenëse çdo këshill i grupit caktohet nga një përfaqësues. Këshilli i prindërve në nivel të kopshtit vepron në bazë të rregullores së punës, kurse të gjitha këshillat tjera kanë programet e punës për aplikimin dhe realizimin e të gjitha formave mësimore dhe jashtë mësimore. Praktika pedagogjike i ka vërtetuar këto forma të bashkepunimit me prindër në mënyrë individuale, grupore dhe kolektive.

Gjatë takimit me prindër mund të merren në shqyrtim shumë çështje që kryesisht kanë të bëjnë me mundësitë e përparimit të procesit mësimor, por edhe me ndërmarrjen e masave për evitimin dhe eliminimin sa më të shpejtë të dukurive negative në procesin mësimor. Me prindër organizohen biseda, këshilla profesionale, ligjerata të ndryshme, etj.

Ky hulumtim, siç e cekta edhe më lart, është i ndërlidhur me faktorët të cilët ndikojnë në nivelin e përgaditjes në fushën e zhvillimit kognitiv, socio-emocional, motorik, gjuhësor dhe matematikor. Këta faktorë kanë të bëjnë me: gjininë, formën e edukimit parashshkollor, nivelin e arsimit të prindërve, vendin ku fëmija jeton si dhe madhësinë e fëmijës.

Në hulumtimin tim, rezultoi se forma më e prshtatshme e edukimit të fëmijës gjatë moshës parashkollore është përfshirja e tyre në kopsht dhe jo në familje. Befasisht kam vërejtur përse i perket zhvillimit socio-emocional se vajzat janë në përparsi.

Niveli i arsimit të prindërve rezultoi të ketë mardhënie pozitive me nivelin e gatshmerisë për shkollë. Fëmijët e rritur në qytet duket se tejkalojnë fëmijët e rritur në fshat në fushën e zhvillimit socio-emocional, motorik dhe gjuhësor, ndërsa madhësia e familjes doli të luante rol vetëm në fushën e zhvillimit socioemocional në të mirë të familjes së vogël. (Dërvodeli, po aty)

E vlerësoj lartë veprën pedagogjike të këtij autori të cilën e kam pasur parasysh.

Edhe pse jam vetëm një individ që po mundohet t'i bëj hapat e parë në hulumtime shkencore, mendoj që kam të drejtë të mendoj ndryshe nga autori i parapërmendur.

Nuk mund të pajtohem me konstatimet e autorit në fjalë i cili mendon që ka dallime në formimin e fëmijëve varësisht nga vendi ku jeton. Në fshat apo në qytet. Mandej, autori nuk i shpjegon fare arsyet as nuk jep fakte për ta bindur lexuesin.

Trupi edukativ ishte i përbërë nga katër edukatore të kualifikuara dhe të trajnuara për punë edukativo-arsimore. Në fillim, në Kosovë nuk kishte edukatore të mirëfillta. Mësueset punonin me shumë zell dhe përkushtim. Ata e ndiqnin me përpikëri planin dhe programin e ofruar nga autoritetet arsimore të nivelit kosovar, ndërkaq fëmijët edukoheshin mirë. Dy palët punonin me dashuri.

Edhe mësueset bashkëpunonin ndërmjet veti, lypnin këshilla nga njëra tjetra dhe nga arsimtarët me përvojë dhe kështu procesi edukativ e arsimor zhvillohej normalisht. Mësueset merrnin këshilla edhe me menaxhmentin për të ngritur në këtë mënyrë cilësinë e edukimit. Ato zbatonin shumë aktivitete atraktive të edukimit. Puna në kopsht dhe sukcesi ishin për lakmi. Prindërit ishin të kënaqur me rezultatet e fëmijëve të tyre²⁴. Ndihma material e prindërve ishte e madhe. Ata siguronin gjithçka kishte nevojë kopshti por edhe shkolla. Në saje të propozimit të vetë diasporës dhe ndihmës së tyre financiare u ndërtua objekti i ri i cili për kohën ishte shumë modern, kishte hapësirë, kishte orendi dhe gjithçka që duhej për vijimin standard të edukimit. Oborri i kopshtit ishte i madh, i rrethaur mire dhe me të gjitha mirat për lojë. Ishte një risi në Zhur, ishte një “mode” të cilën e ndiqnin të gjithë prindërit. Kishte shumë fëmijë.

Në fillim, puna në kopsht organizohej në dy forma të edukimit: grupi i fëmijëve me qëndrim ditor dhe grupi i fëmijëve parashkollorë. Aktiviteti i këtij grupi realizohej me programe të

²⁴Intervistë me prindër dhe me edukatorë, qershor 2017

caktuara edukative. Më së shumti i kushtohej kujdes mirësjelljes së fëmijeve në përgjithësi, kallëximit përrallëzor e tregimeve të lehta, ilustrimet vizatimore, të folurit e bukur, njohja me natyrën në organizim të piknikeve e lojërave të ndryshme në natyrë, njohjet elementare të aritmetikës të përcjellura me figura e materiale tjerë natyrorë. Ishte punë interesante dhe kishte vlera edukative. Fëmijët guzhmonin ! Qytetarët e Zhurit dhe fshatrave për rreth ish-in krenarë!

Cikli parashkollor punon 8 orë me qëndrim ditor dhe 3 orë program përgaditor parashkollor. Koha e punës të shërbimit të përgjithshëm është 8 orë. Institucioni punon gjatë tërë vitit, përveç muajit gusht, të cilin e shfrytëzoi për pushim kolektiv vjetor. Grupet me programin përgaditor parashkollor kanë punuar sipas kalendarit shkollor

Ato vite, si gjithë edhe sot, synimi kryesor i kopshtit, përkatësisht i çerdhes ishte të krijoj kushte të mira për edukim dhe të bashkëpunojë me prindërit, ndërkaq kishte për mision të stimulojë zhvillimin e çdo fëmije si dhe të përgatit ata për arsimimin e ardhshëm. Pëqëndrimi ishte në përparimin e zhvillimit kognitiv, emocional, fizik dhe social përmes argëtimit të ndërsjellë, familjar dhe të pavarur. Pra, loja dhe kreativiteti ishin përbërësit thelbësorë.

Lojrat e fëmijëve janë baza e fëmijërisë së lumtur. Loja, pra, është shprehje e lirisë. Loja përfëmijë nuk është ikje nga realiteti, por mënyrë për të hyrë në realitetin e jetës . Me lojë fëmijët formohen si fizikisht, ashtu edhe intelektualisht e emocionalisht.

Për të arritur sukses duhej punuar në shumëllojshmërinë e aktiviteteve dhe te argëtimit që ofron kopshti për të mbajtur fëmijët e angazhuar. Natyrisht sukcesi varej nga puna e ekipit profesional dhe përkushtimi në punë me fëmijë, ambient i sigurt dhe kushtet e mira për mësim dhe edukim.

Kopshti në Zhur, zhvillon sot veprimtarinë mësimore rregullisht nga dita e hënë deri në ditën e premte. Viti shkollor fillon me 1 shtator dhe përfundon me 20 qershor.

Kopshti në fillim, kishte një muaj pushim në dimër ,tre në verë ndërkaq tash ka dy javë pushime dimërore dhe dy pranverore. Gjithashtu të gjitha festata zyrtare janë ditë pushimi.

Kuadri mësimor në kopsht planifikon aktivitete pedagogjike për t'ua mundësuar fëmijëve të krijojnë, të mësojnë dhe të eksplorojnë për shembull duke luajtur, duke bashkëpunuar me të tjerët, duke pikturuar dhe kënduar.

Godina e kopshtit posedon dhomat e mësimi, këndin e lojës, tualetet adekuate për fëmijë parashkollrë, kuzhinën, korridorin si dhe oborrin e madh dhe të rrethuar. Pra, infrastruktura e kopshtit ofron kushte optimale për mbarëvajtjen e punës edukative- arsimore.

Klasët janë të pajisura me tavolina dhe karrige për fëmijë parashkollrë, televizore, audiosisteme për mësim interaktiv të cilat janë të nevojshme për procesin mësimor bashkëkohor. Kalsët janë të pajisura edhe me material konkretizues që ndihmojnë që fëmijët të mësojnë më lehtë dhe të zhvillojnë të menduarit kritik.

2.3 Organizimi i aktiviteteve

Përveç mësimi në klasë, kopshti organizon edhe aktivitete tjera të ndryshme ku stimulohet puna në grupe, të menduarit kritik dhe kreativ, të mesuarit me projekte, me lojë dhe me këndim.

Ky aktivitet realizohet duke organizuar shetitje në natyrë rreth fshatit, në Vërmicë dhe gjetiu si dhe në qytetin e Prizrenit. Bëhen vizita të ndryshme si në postë, në furrë, në koshtin zoologjik, në Marash, te Muzeu i Lidhjes së Prizrenit, etj.

Të gjitha këto aktivitete të organizuara nga trupi edukativ i kopshtit ndikon pozitivisht në procesin e mësimdhënies, dhe mundëson që të krijohet një klimë positive në kopsht, krijonë tolerancë, bashkëpunim dhe mbi të gjitha duhet të veçohet dëshira e fëmijëve për të mësuar.

Bashkëpunimi me të tjerët është element kyç i suksesit të kopshtit, prandaj edhe menaxhmenti i kushtonë vemendje të posaçme, sidomos bashkëpunimit me prindërit e fëmijëve.

Prindërit konsiderohen si partnerë të rëndësishëm në punën e kopshtit, prandaj bëhen përpjekje që komunikimi me ta të vazhdojë gjatë tërë vitit shkollor.

Nëpërmjet bashkëpunimit dhe komunikimit të vazhdueshëm me prindërit dëshirohet të sigurohet sukses maksimal me fëmijët që ndjekin mësimin në kopsht.

Bashkëpunimi me prindërit dhe komunikimi i rregullt me ta, iu ndihmon që të jenë në dijeni me punën që bëhen me fëmijët e tyre, ndërkaq përmes kësaj rritet edhe besueshmëria.

Përpos me prindërit, rëndësi të madhe ka edhe bashkëpunimi me shoqërinë, sepse menaxhmenti bashkë me fëmijët e shehë vetën si pjesë të komunitetit, ndërkaq ky bashkëpunim ka për synim përfitimin dhe avansimin e kopshtit në shoqëri. Gjithashtu në kopsht mësohet si të mbrohet ambienti, kujdesi ndaj të mirave të përbashkëta dhe shprehitë e mirësjelljes dhe edukatës qytetare.

Krahas bashkëpunimit me prindër dhe me komunitetin, kopshti zhvillon edhe bashkëpunime profesionale edhe me partnerë të ndryshëm të cilët kanë veprimtari të njëjtë apo të përafërt siç është vetë shkolla fillore në Zhur, kopshti në Korishë dhe në Prizren.

Sipas udhëzimeve të MASHT-it, kopshti posedon edhe me rregulloren e vetë e cila ka të bëjë me të drejtat dhe detyrat e fëmijëve parashkollorë, të drejtat dhe detyrat e edukatores, të drejtat dhe detyrat e personelit ndihmës dhe të drejtat dhe detyrat e prindërve të fëmijëve në këtë institucion parashkollor.

Kjo rregullore ndihmonë që puna në kopsht të jetë e strukturuar, sikurse edhe roli dhe përgjegjësia e secilit pjesëmarrës në të.

2.4 Të drejtat dhe detyrat e fëmijës

Sipas dokumentave të shkollës, përkatësisht plan-programet e kopshtit, kemi vërejtur se të drejtat e fëmijëve janë si në vijim:

- të ndjek arsimin në kopsht;
- të merr një edukim qytetar, që do t'i shërbejë formimit të tij moral, shëndetësor, artistik, sportiv, etj.;
- të thotë lirshëm çka mendon dhe të shfrytëzojë tërë veprimtarinë edukative të kopshtit për formimin e personalitetit të tij;
- të kuptojë që të gjithë fëmijët në kopsht janë po aq të rëndësishëm se ai vetë, prandaj t' dojë dhe ti respektojë ata;

- të paraqitet në kopsht, i rregullt, i pastër me veshje të përshtatshme sipas moshës dhe rregullave të kopshtit.

2.5 Të drejtat dhe detyrat e edukatores

Cdo edukator ka pët detyrë të punojë me fëmijë siç e do një institucion edukativ, ndërkaq ata i kanë edhe të drejtat e tyre si në vijim :

- të njohë mirë veprimtarinë mësimore dhe edukative që zhvillohet në kopsht, të drejtat dhe detyrat e fëmijëve në përputhje me normat morale dhe ligjit e shtetit të realizojë një edukim të gjithanshëm demokratik të fëmijëve,
- të shfaqë lirshëm mendimet e saj për veprimtarinë edukative që zhvillohet në kopsht, si dhe metodat bashkëkohore të punës,
- të punojë në mënyrë krijuese dhe me ide origjinale për të organizuar një veprimtari edukative me elemente të reja bashkëkohore në përputhje me interesat e fëmijëve,
- të kualifiohet sipas udhëzimeve të MASHT-it, si dhe të vetëkualifikohet duke shfrytëzuar literaturën bashkëkohore dhe veprimtarinë praktike në kopsht,
- të trajtohet me respekt dhe dinjitet njerëzor, pa presion, pa dhunë, pa fyerje, -të merr dhe të ofrojë përvojë pune te kolegët,
- të zbatoj me rigozitet rregulloren e brëndshme të institucionit dhe të formojë drejtesinë për çdo të metë dhe dobësi që vëren në mbarëvajtjen e punës në kopsht,
- të kërkojë mbajtjen pastër dhe të rregullt të mjediseve të kopshtit nga fëmijët dhe së bashku me punëtorët të mbajë përgjegjësi për bazën materiale të grupit ;
- të mbajë pastër dhe të sistemojë mjetet didaktike dhe lodrat në qendrat e aktivitetit, tavolinat, raftet, etj. ;
- të krijojë marrëdhënie të mira me prindërit e fëmijëve dhe të dëgjojë me vëmendje çdo vërejtje dhe sugjerim të tyre ;
- të informojë prindërit për mbarëvajtjen dhe shëndetin e fëmijës në kopsht dhe të jep ndihmën e parë në rast urgjence ;

- kur mungon, të njoftojë drejtuesit e institucionit për arsyen e mungesës dhe kohën që do të mungojë ;
- të plotësojë dhe të mbajë në rregull dokumentacionin e grupit ; -të ketë paraqitje të rregullt dhe veshje të përshtatshme.

2.6 Te drejtat dhe detyrat e personelit ndihmes

Si punëtorët tjerë edhe personeli ndihmës i gëzon të drejtat e veta , ndërkaq duhet të kryej detyrat për të cilat është angazhuar:

- të paraqitet në punë në orarin e caktuar;
- të përgjigjet për rregullin dhe pastërtinë gjatë qëndrimit të fëmijëve në kopsht;
- të përgatis ushqimin dhe t'ua shërmdajë fëmijëve si dhe të kujdeset për ta gjatë ngrënies;
- të bëjë pritjen dhe përcjelljen e fëmijëve dhe të kujdeset për ndërrimin e mbathjeve;
- të ketë paraqitje të rregullt dhe veshje të përshtatshme.

2.7 Të drejtat dhe detyrat e prindërit

Mund të thuhet se prindi i ka detyrat më të vështira, sepse bëhet fjalë për fëmijun e tij, ndërkaq i ka edhe të drejtat që po i paraqesim më poshtë:

- të merr informacione të detajuara për zhvillimin e gjithanshëm të fëmijës, për sjelljen dhe shëndetin e tij, si dhe ndihmë për edukimin familjar,
- për të metat dhe dobësitë që vërenë në punën e edukatoreve dhe të personelit ndihmës, të informojë drejtuesit e institucionit;
- të bëjë regjistrimin e fëmijës në kopsht brenda periudhës së caktuar;
- të paguaj obligimet e fëmijut për kopsht dhe të respektojë rregulloren e brendëshme të kopshtit;
- të veshë fëmijën siç e kërkon koha;
- të merr pjesë në mbledhjet vendimtare dhe të jep mendimin e vet.

2.8 Lista e teksteve dhe mjeteve edukativo-arsimore që përdoren aktualisht gjatë punës në kopsht:

Më vjen keq që nuk kam mundur të siguroj tekste nga periudha e para luftës, sepse me gjasë ata janë zhdukur, por e kam të dëgjuar nga personeli arsimor i shkollës fillore në Zhur, se tekstet për kah përmbajtja kanë qenë të përafërmë me këta të ditëve tona, sepse qëllimi ka qenë i njejtë. Natyrisht, mjetet teknologjike kanë ndryshuar bashkë me kohën e kaluar.

Tekstet:

- Ne dhe shkronjat;-
- Unë dhe numrat;-
- Unë dhe arti;
- Unë dhe mjedisi;
- CD- Këngët e Mias;
- Alfabeti pazell

Mjetet didaktike shoqëruar të paketës “ Një hap drejt shkollës” Për formimin gjuhësor:

- Me pak fjalë (8 tituj); kutia me fisha dhe CD-luaj me shkronjat;
- ABC (DVD); Pino-Alfabeti prej druri, lodra të ndryshme pino, etj,;
- Nga seria MIUSHI MAGJIK- fjalët e mia të para, Për formimin social:
- Seria- Lodrat Pini; lodrat pino të ndryshme me pazell, pino ushqimet, etj.,
- lodrat pino të ndryshme për pazell- vishe vajzën, vishte djalin, pino ushqimet, pino pemët- perimet, etj.

Për formimin shkencor:

- Lodrat pinot e ndryshme pazell, mjetet e udhëtimit, kafshët e gëzuara, pino me magnet peshkimi, etj.
- Njohë natyrën, Njoh kafshët, lodrat e pinot e ndryshme, pino magnetpeshkimi ; kafshët e gëzuara.

Për formimin matematikor:

Pin-kube didaktike, Pino-Metri, Pino-ora, Domino-format gjeometrike, etj.

Pino kube; pino metri; pino ora; pino-logjike, etj.

Për formimin artistik:

Pino instrumentet ;pinoflauti;pino-daullja; pino-harmonika.

2.9 Programet sipas grupmoshave

Sipas udhëzimeve të MASHT-it, në kopsht ka programe të shkëlqyera për fëmijët që përgatiten për të shkuar në shkollë.

Programi ka për synim që fëmijët të mësojnë nëpërmjet lojës. Në këtë mënyrë ata mësojnë për ta kuptuar jetën dhe botën që i rrethonë.,

Programi mësimor që zhvillohet në këtë kopsht është për fëmijët e moshës 4-5 vjeç dhe 5-6 vjeç.

Qëllimi i programit është që fëmijët të jenë të suksesshëm në vijimin e shkollës dhe përgjatë gjithë jetës së tyre.

Në programin për fëmijët 5-7 vjeç janë të përfshirë : zhvillimi gjuhësor, zhvillimi social dhe emocional, zhvillimi matematikor, zhvillimi shkencor si dhe zhvillimi artistic dhe zhvillimi fizik. Në kuadër të zhvillimit gjuhësor përfshihet edhe gjuha angleze.

Ndërsa programi për fëmijët 3-5 vjeç ju ofron fëmijëve kohë dhe hapësirë për të zhvilluar potencialet e tyre për një kalim sa më të lehtë në programin e përgatitjes për në shkollë.

Programi përfshinë : gjuhë, matematikë, shkencë, art, gjuhë angleze.

Fëmijët inkurajohen të punojnë në grupe të vogla dhe të mëdha, brënda apo jashtë ambienteve të kopshtit.

Në këtë kopsht punohet me programet që po iparaqes në vijim:

-Paketa “ Një hap drejt shkollës”për fëmijë 5-6 vjeç, është hartuar në përputhje me programin e MASHT-it për edukimin parashkollor.

Paketa shoqërohet me një udhëzues për edukatorët dhe prindërit, të cilët do ta ndjekin ecurinë e fëmijëve gjatë një viti shkollor.

Në udhëzues zberthehen objektivat e temave sipas kërkesave të programit : njohuritë gjuhësore, matematikore, shkencore, të edukimit personal e shoqëror dhe artistik, të cilat janë shtjelluar në katër tekstet përkatëse. Plani është i organizuar në muaj dhe javë.

2.10 Planifikimi mësimor dhe metodat

Çdo ditë mësimore zhvillohen dy lëndë bazë, njëra prej të cilave është lënda e gjuhës, e cila zhvillohet katër ditë në javë. Krahas gjuhës, fëmijët mësojnë matematikë, dy ditë në javë, dhe marrin njohuri nga arti e mjedisi. Një vend i rëndësishëm i është lënë përvetësimit të gjuhës shqipe : të folurit, pasurimit të fjalorit me fjalë e shprehje të tematikave të ndryshme, si dhe dallimit të tingujve e shkronjave të mëdha e të vogla të shtypit. Dita e premte është lënë për përsëritje.

Duke pasur parasysh moshën dhe nivelin e kultures dhe të njohurive që ka një fëmijë, është treguar kujdes i veçantë në përzgjedhjen e pasur të metodave të përdorura. Në etapën parapergatitore, për të nxitur njohuritë që fëmijët i kanë, si dhe për ta futur natyrshëm dhe gëzueshëm në procesin e të nxënies, parashikohen lojërat lëvizore dhe argëtuese, bashkëbisedimi, kënga, shfaqja e filmave, etj.

Në etapën e dytë, e cila është etapa e realizimit, paraqiten njohuritë e reja, vendin kryesor e zënë lojërat mësimore, leximi i tregimeve e vjerrashave, loja në role, puna e dorës, si dhe gjithçka që nxit fëmijët.

Në etapën e tretë, etapa e reflektimit, vendin kryesor e zënë metodat që nxisin fëmijët të mendojnë për atë çka kanë mësuar. Poashtu, pas çdo aktiviteti fëmijët duhet të motivohen nga ana e edukatores, për punë më të suksesshme në të ardhmën.

Si mësues që jemi, nuk mund të themi se vërtet kemi dhënë mësim, nëse dikush nuk ka mësuar diçka prej nesh. Pra, për të qenë edukatorë të mire, duhet të mendojmë për:

- Si mendojnë fëmijët;
- Si mësojnë ata;
- Si mendojnë të rriturit, dhe -Stilet e të mësuarit të fëmijëve.

Paketa « Hop-hop » për fëmijët 4-5 vjeç, janë paraparë “Faqet argëtuese”

Paketa “Hop- hop” është krijuar nergut për t’i mësuar fëmijët nëpërmjet zbavitjes, prandaj edhe quhet “Faqet argëtuese”.

Qëllimi i këtij program është zhvillimi i fantazisë dhe i nxitjes së krijimit të ideve të fëmijëve të kësaj moshe. Zakonisht në këtë program punohet në grupe, sepse kjo mënyrë e punës është e dobishme për zhvillimin e anës psiko-motorike. Në këtë mënyrë edhe fëmijët që janë më të tërhequr, shkathtësohen fizikisht dhe flasin, ndërkaq duke folur, ata njohin më mirë veten.

Nëpërmjet fantazisë, muaj pas muaji, deri në fund të vitit parashkollor fëmijët do të realizojnë bashkë me edukatorët një projekt madhor, të cilin do ta shfaqin para prindërve dhe të ftuarve të tjerë. Kopshti ynë psh. ka shfaqur këtë fund viti shkollor programin : para prindërve, arsimtarëve dhe qytetarëve tjerë ,shfaqen “Lamtumirë, kopshti im”. Ky program u ndoq me shumë kureshtje nga të pranishmit. Në fund, fëmijët, u ngazëllyen nga duarrokitjet e publikut.Fëmijët nuk do ta harrojnë këtë program. Ky program dhe kjo ditë është pjesë e formimit estetik të fëmijëve, është plotësim i zhvillimit emocional, social gjuhësor dhe muzikor. Me një fjalë është formim i personalitetit të tyre. Është pjesë e mirësjelljes së tyre.

Nga që u tha deri më tash, delqë misioni i kopshtit ka për obligim që të stimulojë zhvillimin e mësimin të çdo fëmije si dhe të përgatit fëmijët për arsim të ardhshëm. Synimi është në promovimin e zhvillimit kognitiv, emocional, fizik, social, përmes argëtimit interaktiv, familjar dhe të pavarur.Pra, loja dhe kreativiteti janë komponentet thelbësore të formimit të karakterit dhe aftësive tjera morale.

Në varësi nga mosha dhe aftësitë e fëmijëve, edukatorët në suaza të planit vjetor, mujor, javor dhe ditor i realizojnë detyrat dhe aktivitetet programore me fëmijët e grupmoshave të caktuara.

Përshtatja e fëmijëve në kopsht është një proces i cili nis me shkëputjen e fëmijës nga ambient familjar dhe pranimin e një ambient të ri, në rastin konkret ambient përkujdesës dhe edukues ku edukatorët kujdesen për fëmijët të cilët janë afërsisht të një grupmoshe.

Pavarësisht karakteristikave zhvillimore të grupmoshës, çdo fëmijë ka karakteristikat e tij personale që përfshijnë mënyrat e reagimit ndaj situatave, sjelljet ndaj vetës dhe të tjerëve, nivelin zhvillimor në raport me grupmoshën, mënyrën e përkujdesjes së deritashme, raportin dhe lidhjen me nënën, babain ose kujdestarin.

Edhe pse deri më tash u fol për çiptazi për faktorë të ndikojë në formimin e fëmijëve, duhet veçuar dy që janë kryesor e që ndikojnë në përgatitjen e fëmijëve.

2.11 Faktorët kryesorë që ndikojnë në përgatitjen e fëmijëve parashkollorë

Faktorët që ndikojnë në përgatitjen e fëmijëve janë, edukata që e merr fëmiju në familje, gjendja ekonomike në të cilën rritet ai, rrethi shoqëror dhe ekonomik, ambienti i entit edukativ dhe të tjerë. Ne do t'i marrim parasysh vetë dy që I vlerësojmë si kryesorë:

1. Familja dhe

2. Institucionet edukative

Ndikimi i prindërve apo familjarëve të fëmijëve është thelbësor në përshtatjen e fëmijëve me kopshtin. Edukatën që e ka marrë në familje në fëmijërinë e hershme mund të manifestohet edhe në kopsht.

Fëmijët vështirë përshtatet nëse prindërit dhe kujdestarët nuk janë gati për t'u shkëputur nga ai. Pra, para se ta dërgojnë fëmija në kopsht prindërit duhet ta përgatisin vetën. Është edhe personeli i kopshtit, veçanërisht gadishmëria e edukatorevku do të qëndrojë fëmija.

Në këtë moshë janë disa aktivitete që mund të ndikojnë në përshtatjen më të shpejtë të fëmijëve me kopshtin.

Angazhimi i fëmijëve në aktivitete kreative bëhet përmes lodrave, muzikës, përrallave, dramatizimit, etj. Ky angazhim ndihmon përshtatjen sa më të lehtë dhe të shpejtë të fëmijëve në kopsht, për forcimin e fëmijës në aspektin emocional dhe social me kopshtin, përkatësisht me edukatoren, me fëmijët tjerë, me lodrat dhe në përgjithësi me ambientin edukativ në kopsht.

Përgatitja e fëmijës për kalimin nga shtëpia në kopsht duhet të bëhet para se të fillojë të shkojë në të, duhet të njihen se së shpejti do të takojë fëmijë tjerë, një mjedis të ri dhe do të qëndrojë disa orë larg prindërve. E gjithë kjo mund të bëhet në familje përmes lodrave, përrallave dhe bisedës nga ana e prindërve.

Loja është mjet themelor që krijon mundësitë për hyrje në raporte me të fëmijëve, është mjet i domdoshëm për çdo edukator përmes të cilit mund t'i arrijë qëllimet edukative dhe pedagogjike.

Duke u bazuar në analizën e teorive mbi zhvillimin e fëmijëve të moshës parashkollore, literaturën e bollshme mbi edukimin parashkollor që kam pasur parasysh, studimet pesë vjeçare universitare, stazhet nëpër kopshte si dhe praktikën time në edukim dhe arsim, nuk ka dyshim se kjo moshë themelin e edukimit të mëtejëm e merr në familje dhe se nga kjo moshe varet zhvillimi i individit në tërësi. Me një fjalë, në institucionin parashkollor fëmija arrinë pjekurinë e duhur dhe përgatitjen për të filluar klasën e parë të shkollës fillore. Prandaj, është obligim i prindërve dhe i edukatorëve që të sigurojnë ambient dhe mundësi në mënyrë që fëmijët të kenë fillim të mbarë, sepse fëmijët e përgatitur mirë do të jenë një hap para fëmijëve që klasën e parë e fillojnë me pasiguri, frikë dhe inferioritet.

Sipas Afërdita Zuna-Deva (200) e cila ka shfrytëzuar mendimet pedagogjik të pedagogëve dhe psikologëve të shquar, ajo na jep një pasqyrë të qartë të vlerës që ka familja në edukimin e drejtë të fëmijës parashkollor.

Sipas Zuna-Devës, « roli dhe rëndësia e prindërve në zhvillimin dhe edukimin mendor të fëmijëve të moshës parashkollore në familje është i pamohueshëm, duke marrë parasysh plasticitetin, ndieshmërinë, aftësitë e tyre për të kuptuar shpejt »²⁵.

Autorja ka identifikuar tre tipa të familjeve që janë karakteristike për Kosovën:

- tipin patriarkal
- tipin demokratik dhe;
- tipin anarkik të familjes.

Të tre këto tipe të familjeve do të kenë influencë të ndryshme në raport me fëmijët. Nëse tipi i familjes është patriarkal, fëmijët parashkollorë të këtyre familjeve nuk do të kenë mundësi të njejta të edukimit për nga dallimet gjinore dhe ato moshore.

Fëmijët parashkollorë që edukohen në familje demokratike, pritet të kenë edukim më të drejtë dhe padallime të asnjë lloji.

²⁵(Zuna-Deva, *Edukimi i parashkollorit në familje*, Prishtinë, 2003)

Ndërkaq fëmijët e familjeve anarkike do të jenë fëmijë që nuk dijnë për asnjë lloj kufizimi të asaj që është standarde, prandaj ata do të jenë të një çrregullimi total. Fatkeqësisht familje të tilla ka shumë në Kosovë dhe fëmijët e tyre ndjellin problem të llojllojshme në shoqërinë tonë.

Me gjithë përpjekjet e mia, për ta gjetur ndikimin e faktorëve edukativë, sidomos atë të familjes dhe të rrethit, nuk kam hasur në asnjë fjalë të shkruar për bonjakë, pa një apo pa dy prindër. Nuk kam hasur gjë as për fëmijët me prindër të ndarë, madje as për fëmijët e komunitetit rom, madje edhe atyre të varfër.

Me gjithë mungesën e të dhënave për këto kategori fëmijësh, jam përpjekur ta përshkruaj me pak fjalë gjendjen e tyre nisur nga përvoja ime.

Si në punë dhe në trajnimet e mia në Zhurë, Korishë dhe sidomos e patjetër në Prizren.

Në fakt, kam konstatuar se në Zhurë fëmijët bonjakë janë më të ndrojtur në lojë, dhe të gjithëve ju mungon buzëqeshja. Mund të them se edhe fëmijët me prindër të ndarë janë më të mbyllur, të pikëlluar dhe të tërhequr.

Fëmijët romë, ndonëse të rrallë në kopshte, janë edhe më refuzues se të tjerët edhe pse numri i tyre është simbolik. Ndërkaq, fëmijët e familjeve të varfëra janë të padisciplinuar dhe agresivë. Del që këta fëmijë t'i takojnë tipit anarkik

Kjo kategori fëmijësh del gjithashtu të jetë e paedukuar. Ata për shembull, gjatë ngrënjes presin që ta shijojnë ushqimin por nuk e presin fillimin si për të gjithë. Hajnë shpejt dhe me gojë të hapur. Nuk i përmbahen asnjë rregulle të mirësjelljes. Ka edhe gjeste tjera të pahishm!

Edukimi parashkollor fëmijëve varet në masë të madhe edhe nga ndikimi i prindërve, ndërkaq për këtë, është e domosdoshme që prindërit duhet të jenë të pajisur me njohuri pedagogjike e psikologjike.” Këto njohuri do t'i bëjnë prindët më kompetentë dhe më aktivë në edukimin e fëmijëve edhe të moshës parashkollorë, Ata do të jenë më të sigurtë në veprime edukative me parashkollorë, do të jenë më të përgjegjshëm në aspektin edukativ, do të angazhohen në tejkalimin e vështirësive me të cilat ballafaqohet gjatë edukimit të fëmijëve” (Deva –Zuna (po aty). Rrjedhimisht, mund të konstatojmë se, fëmijët të cilët gjatë moshës parashkollorë edukohen në familje, jo rrallë mund të kenë fatin që për ta të kujdesen prindërit, të cilëve, u mungon kultura

pedagogjike dhe kjo sjell për pasojë që fëmijët të jenë, jo të edukuar drejt dhe të papergaditur për shkollim fillor.

Përfundimin që nxjerr autorja, del që mendimi pedagogjik bashkëkohor, familjen e konsideron faktor fundamental të edukimit të fëmijëve parashkollorë.

Ajo gjithashtu bënë kategorizimin e moshës parashkollor në tri etapa, duke filluar nga mosha e re parashkollorë që përfshinë moshën 3 deri 4 vjeç, moshën e mesme parashkollorë prej 4 deri 5 vjeç dhe moshën e madhe parashkollorë, 5 vjeç deri sa fëmija të hyjë në shkollë. Sipas saj, edhe pse mosha parashkollorë përfshinë një periudhë relativisht të shkurtër të jetës së njeriut, ajo është periudhë tejet e rëndësishme.

Zhvillimi në moshën parashkollorë përfaqëson bazën e formimit të personalitetit të mevonshëm, Zhvillimi i fëmijës në periudhën parashkollorë ka disa karakteristika të përgjithshme siç janë: formimi i personalitetit cili fillon me lindjen e fëmijës e është tepër intensiv, si në aspektin anatomiko- fiziologjik ashtu edhe në aspektin e sjelljes. Tempoja e zhvillimit individual ndryshon nga fëmija në fëmijë

Zhvillimi i personalitetit i fëmijës së kësaj moshe, bëhet nën ndikimin e faktorëve të lindur, faktorëve të mjedisit ku jeton, edukatës dhe aktivitetit të vet fëmijës. Njëri ndër faktorët e jashtëm që ushtron ndikim në formimin e fëmijës së moshës parashkollorë është pikërisht familja.

Gjurmet e edukimit janë aq më të thella sa më i vogël është fëmija dhe se rezultati edukativ është aq më i thellë sa më shumë zgjatë ndikimi i të njejtit edukator në fazën e kësaj moshe edukimi.

Megjithë lartësimin e rolit të familjes që ka në edukimin e fëmijëve parashkollorë, autorja, asnjë herë nuk vë në dyshim rëndësinë e faktorëve tjerë edukativë e sidomos kur është fjala për edukimin e institucionalizuar nëpër çerdhe e kopshte të fëmijëve. Ajo arrin në përfundim se fuqia e funksionit pedagogjik të familjes, në periudhën parashkollorë, varet nga niveli i kultures edukative të familjes.

Edhe Dervodeli²⁶, një autoritet pedagogjisë në Kosovë, flet për rolin e familjes në përgatitjen e fëmijës për nisje në shkollë. Ai thekson se edukimi i fëmijës në familje është një parakusht mëse i nevojshëm për zhvillimin dhe formimin e drejtë të fëmijës.

Autori flet edhe për normat e sjelljes morale, të formimit të vullnetit dhe karakterit, zë të ndjehet i pavarur, zhvillon aftësitë e tij psiko-fizike, zhvillohet edhe në aspektin social e emocional, e pasuron fjalorin, përvetëson njohuri elementare nga dituritë natyrore dhe shoqërore, nga matematika, etj. Të gjitha këto janë parakusht i mundshëm i përgatitjes së duhur të fëmijëve në familje për nisje në shkollë. Në raste të shpeshta, prindi mund të mos e di nëse fëmija i moshës 6,7 e 8 vjeç nuk do të thotë se janë të zhvilluar njësoj, në aspektin e moshës kronologjike dhe të asaj zhvillimore, sepse inteligjenca, mënyra e të menduarit të tyre pastaj zhvillimit social, emocional e fizik- shëndetësor, të gjitha zhvillohen me rrjedha individuale « (Dervodeli, po aty).

Dervodeli²⁷ jep disa rekomandime për prindërit, në mënyrë që fëmijët të shkojnë të përgatitur në shkollë. Ndër të tjera, ai thekson se prindërit duhet të njoftojnë fëmijën me kohë, se shkolla është një vend, ku ai do të shkojë të mësojë shumëçka dhe ku do të njohë shumë gjëra të mira. Te fëmija, prindërit nuk duhet të mbjellin frikën nga shkolla dhe mësuesi.

Dervodeli²⁸ pohon se jo të gjithë prindërit kanë përgatitje të mjaftueshme pedagogjike, dhe se shpesh nga dëshira e madhe që fëmija të ketë sukses për të shkuar përpara, mbivlerësojnë ose nënvlërësojnë aftësitë e fëmijëve të tyre e me këtë gabojnë edhe në vendimin e tyre për të regjistruar fëmijën në klasën e parë. Për përgatitjen e fëmijës për klasë të parë, atyre u nevojitet të respektojnë disa kërkesa elementare si në vijim :

- sjellja e mirë e prindit ndaj fëmijës, duke respektuar personalitetin e tij, duke mos i anshkaluar aftësitë dhe veçoritë e zhvillimit të tij²⁹;
- perkujdesi fiziko- shëndetësor dhe ushqimi i nevojshëm, me qëllim që fëmija të ketë gjendje të mirë shëndetësore dhe zhvillim të drejtë trupor ;

²⁶Dervodeli, Januz, *Dallimet në sukseset e nxënësve të shkollës fillore të regjistruar para kohe, me kohë dhe pas kohe, Prishtinë 2011*

²⁷po aty

²⁸po aty

²⁹Dervodeli, po aty, faqe 121

- të kuptohen interesat dhe nevojat e fëmijëve dhe të përmbushen ato, veçmas përmes lojës; të motivohen aktivitetet motorike, gojore dhe të tjera të fëmijës ;
- t'u mundësohet shoqërimi në lojë me rrethin e moshatarëve të tij dhe sipas mundësive fëmija të vijojë institucionin parashkollor, së paku një vit para se te vijojë shkoëllën ;
- të bëhet orientimi i drejtë i fëmijës ndaj vlerave kulturore, etike, estetike, sociale dhe vlerave të tjera të shoqërisë ;
- krijimi i një atmosfere të ngrohtë jetësore për fëmijen;
- prindërit duhet ta kenë të qartë se fëmija nuk mund të përgaditet për shkollë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe as një vit para fillimit të klasës së parë, por duke filluar nga periudha më e hershme e moshës së tij.

Hulumtimet kanë treguar se gatishmëria për shkollë parashikon suksesin e mëvonshëm në shkollë. Për këtë arsye, duhet mundësuar përvoja pozitive për fëmijët, duke filluar nga lindja që të rritet gatishmëria për shkollë. Meqenëse edukimi fillon në shtëpi dhe prindërit janë mësuesit më me ndikim i fëmisë, përkrahja dhe edukimi i prindit paraqet një strategji logjike. Prindërit të cilët janë përfshirë në edukimin dhe përkujdesin e hershëm kanë fëmijë më të përgatitur për shkollë.

Si përfundim, analizat e këtij studimi konstatojnë se si qëndrimet e prindërve ashtu edhe sjellja e tyre kanë ndikim në përgatitjen dhe suksesin e fëmijëve në klasën e parë në aspektin e zhvillimit kognitiv dhe socio-emocional. Megjithatë, studimi vë në pah se përderisa disa qëndrime dhe sjellje të prindërve ndikojnë në zhvillimin e fëmijëve gjatë moshës parashkollore, ato nuk ndikojnë aq shumë në suksesin e fëmijëve në fund të klasës së parë

Duke u bazuar në hulumtimet e më sipërme mund të themi se edhe pse familja luan një rol kyq në edukimin e fëmijëve të moshës parashkollore dhe veçanërisht në përgatitjen e tyre për klasë të parë, edukimi në familje gjatë kësaj moshe nuk duhet të jetë bartës i vetëm ose kryesor. Prindërit dhe anëtarët tjerë të familjes mund të ndimojnë në përgatitjen e fëmijës për klasën e parë në masë të madhe duke i mbështetur ata, krahas edukimit të instiucionalizuar në ente të edukimit parashkollor.

2.12 Institucionet edukative

« Roli i edukimit parshkollor të instucionalizuar në përgatitjen e fëmijëve në përvetësimin e shkronjave, të leximit dhe të shkrimit duhet kuptuar e shtruar në drejtim të përgatitjes së përgjithshme të fëmijët parashkollorë, që përfshinë, ndër të tjera, edukimin në aspektin senso-motorik, psiko-social e intelektual. Përgatitja parashkollore për njohjen dhe mësimin e shkronjave, të leximit dhe të shkrimit nuk duhet kuptuar si përgatitje të veçantë për shkollë. Një trajtim i tillë i fëmijëve do ta tjetersonte ; do ta shkepuste atë nga gëzimi dhe përjetimet jetësore parashkollore “ (Mulla, 2011, cituar nga Dërvodelli))

Autorët e parapërmendur bijnë në kundërshtim me njëri tjetrin kur i trajtojnë fëmijët zonave rurale dhe urbane.

Ata konfirmojnë që ekzistojnë dallime në mes të fëmijëve që jetojnë në qendra urbane dhe në zona rurale.

Te fëmijët e familjeve me madhësi të ndryshme, ekzistojnë dallime në nivelin e gatishmërisë për klasë të parë varësisht nga madhësia e familjes.

Më habit fakti që as Zuna- Deva, as Dërvodeli nuk japin shpjegime rreth motiveve të ekzistimit të dallimeve mes zonave urbane dhe rurale.

Fëmijët e edukuar në institucione parashkollore- kopshte, janë më të përgatitur për klasë të parë në aspektin social- emocional, kognitiv, motorik, gjuhësor dhe matematikor se sa fëmijët e edukuar në familje.

2.13 Niveli i arsimimit të prindërve

Në kontekstin kosovar, prindërit apo nënat me nivel të ulët të arsimit kryesisht nuk janë të punësuar dhe në pozitën e tyre prej shtëpijakeje shpesh i kushtojnë më shumë se sa duhet kujdes fëmijëve të tyre, duke veshur e zhveshur, duke i ushqyer e pastruar dhe në këtë mënyrë pa dashje, pengojnë zhvillimin e tyre, sepse fëmijët kanë nevojë për çdo mundësi për t'i bërë gjërat vet.

Nga ana tjetër prindërit më pak të arsimuar duket të kenë më pak ndikim tek fëmijët sa i përket gadishmërisë për shkollë. Prindërit me nivel të ulët të arsimit kanë edhe paga më të ulta, kështu që interesimi kryesor i tyre është te mbijetesa e familjes.

Për nivelin e arsimit të nënës, kjo ndërlidhje duket të jetë sërish domethënëse. Duke u bazuar në këto të dhëna sërish mund të supozojmë se ndikimi i nënës është më i madh se i babait, sigurisht ndikuar nga koha e cila kalohet së bashku me fëmijët.

Siç po shihet, fshatrat e mëdha të Kosovës kanë kryesisht kopsht ose vit parashkollor, por ka fshatra të mëdha me gjithë qytetet që kanë edhe çerdhe edhe kopsht, prandaj e shoh të rrugës ta paraqes në vjim edhe programin e fëmijëve që e ndjekin çerdhe, kopshtin ose edhe vitin parashkollor.

2.14 Puna me fëmijët e moshës 1 – 3 vjeç dhe 3-6.5

Puna edukativo-arsimore me fëmijët e moshës 1-3 vjeç është planifikuar sipas bazave të përbashkëta të edukimit dhe arsimit për fëmijët 1-3 vjeç. Puna edukative me fëmijët e moshës deri 3 vjeç, realizohet përmes përkujdesjes profesionale për arsye të specifikave të zhvillimit psikik, sepse lidhja e ngushtë në mes të zhvillimit fizik dhe atij psikik, inponon edhe bashkimin e edukimit dhe përkujdesjen ndaj fëmijëve të vegjël.

Prej themelimit të çerdhes në Zhur nuk ka pasur çdo vit shkollor fëmijë të kësaj moshe meqenëse prindërit vet janë marrë me ta.

Gjatë qëndrimit tim dhjetë ditë, dy javë pune, kam vërejtur që fëmijët janë të kënaqur me sjelljes dhe qëndrimin e edukatoreve ndaj tyre dhe nuk ka pasur lëshime serioze gjatë punës. Po ashtu me kënaqësi mund të shprehem se puna edukativo-arsimor me fëmijë të vegjël është realizuar me sukses.

2.15 Puna me fëmijët e moshës 3-6.5 vjeç

Puna edukativo-arsimore me fëmijët nga 3 deri në 6.5 vjet është planifikuar sipas bazave të programit edukativo-arsimore me fëmijët deri 6.5 vjeç. Planifikimi dhe organizimi i punës edukativo-arsimore është bërë çdo muaj të punës në nivel të grupit edukativ, në bazë të vërejtjeve dhe karakteristikave të aftësive të fëmijëve si individë ashtu edhe grupet në tërësi, si dhe në bazë të metodave dhe veprimtarive të programit të punës për moshën 3-6.5 vjeç. Edukatorët me kreativitetin dhe profesionalizmin e tyre në bashkëpunim me prindërit e fëmijëve kanë bërë planifikimin, zgjedhjen e metodave të punës dhe e mjetet edukative për realizimin e procesit arsimor.

Evidenca për realizimin e programit është shënuar çdo ditë në ditaret e punës së edukatoreve. Të gjithë fëmijët e moshës 1-6.5 vjeç janë radhitur sipas këtyre grup moshave :

Ditari i edukimit parafillor është dokument kryesor në të cilin evidentohet e tërë veprimtaria edukative- arsimore e secilit fëmijë në klasë apo grup. Për shkak të rëndësisë së veçantë të këtij dokumenti, edukatorja është e obliguar ta ruaj dhe ta plotësojë me kujdes :

- orarin e punës edukative, orari fillimit dhe mbarimit të punës edukative ;

- shënohen tekstet që përdoren sipas fushave autorët e teksteve, shtëpia botuese dhe viti i botimit. Në fund shënohet emri i edukatores;
- evidentohen shënimet personale të fëmijës dhe prindit të tij;
- tabela për gjendjen familjare të fëmijës: emri dhe mbiemri i fëmijës, pa një prind, pa dy prind, prindër të shkurorizuar, fëmijë në jetimore, emri dhe mbiemri i kujdestarit të fëmijës;
- shënohet plani vjetor i punës educative, duke u mbështetur në kurrikulën e edukimit parashkollor;
- shënohet realizimi ditor i aktiviteteve të planifikuara sipas fushave të kurrikulës dhe mungesat e fëmijëve, komentet dhe në fund planifikimi i aktiviteteve ditore të planifikuara, të mbajtura dhe të pambajtura;
- shënohen aktivitetet vjetorë të planifikuara, të mbajtura dhe të pambajtura sipas fushave të kurrikulës;
- vlerësimi përshkruar për fëmijët- për dy gjysmëvjetorët- të arriturat e fëmijës duke u mbështetur në të priturat e përcaktuara në kurrikulën parashkollore dhe në standardet e zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme;
- shënohet evidence e konsultimeve të edukatoreve me prindër, rendi i ditës, data, diskutimet dhe konkluzionet;
- shënohen procesverbalet e këshillave të grupeve educative, rendi i ditës, data, diskutimet dhe konkluzionet;
- shënohet lëvizja e fëmijëve gjatë vitit shkollor, pasqyra e mungesave të fëmijëve dhe numri i fëmijëve me nevojë të veçanta arsimore;
- shënohen trajnimet profesionale të edukatores të klasës ose grupit;
- shënohen momentet e veçanta gjatë vitit shkollor;
- shënohet procesverbali mbi praninë-dorëzimin e librit të punës educative.

- vendimi i MASHT-it, nr.2-2015 për përcaktimin e përmbajtjes dhe formës së ditarit të klasës.
- grupi i fëmijëve 1-3 vjeç
- grupi i mesëm i fëmijëve 3-5 vjeç
- grupi i rritur i fëmijëve 5-6.5 vjeç
- grupet e fëmijëve parashkollorë 5.5-6.5 vjeç

Grupi i fëmijëve të moshës parashkollorë është organizuar në hapsirat e kopshtit. Koha e qëndrimit të fëmijëve në kopsht dhe hapësirat e adaptuara është 5 orë gjatë ditës dhe me ata punon një edukatore. Në çdo grup të fëmijëve me qëndrim ditor kanë punuar nga 2 edukatore, të cilat së bashku kanë planifikuar edhe realizuar punën në bashkëpunim me prindërit. Përkujdesja dhe puna edukativo-arsimore paraqet bazën e tërë veprimtarisë së kopshtit e që është planifikuar:

1. Në bazë të programit shëndetësor
2. Në bazë të programit të punës edukativo-arsimore me fëmijët e moshës deri në 3 vjeç
3. Në bazë të programit të punës edukativo-arsimore me fëmijët e moshës nga 3-6.5 vjeç

Veprimtaritë themelore, si edukimi dhe arsimimi, mbrojtja shëndetësore, përkujdesja dhe ushqimi, si dhe mirërritja e fëmijëve të moshës deri në 6.5 vjeç, është realizuar në kushte relativisht të volitshme.

Kopshti ka të punësuar 6 puntorë të të gjitha profileve prej të cilëve 4 në punët edukativo-arsimore.

Në programin përgaditor parashkollor dhe në programin e qëndrimit ditor kanë qenë të përfshirë 40 fëmijë të moshës nga 1 deri 6.5 vjeç. Kopshti gjatë tërë vitit ka bërë regjistrimin e fëmijëve të rinj duke i plotësuar në këtë mënyrë kërkesat e tyre dhe kërkesat e prindërve, kështu që deri në mbarimin e vitit, numri i fëmijëve me qëndrim ditor është rritur, ndërsa numri i fëmijëve që kanë vijuar mësimin përgaditor parashkollor ka mbetur i njëjtë, sepse që në fillim të vitit përfshirja e fëmijëve në programin parashkollor ka qenë 100 përqind. Koha e punës së Kopshtit ka qenë e përshtatur për të gjithë prindërit. Një pjesë e konsiderueshme e prindërve

nuk kanë shprehur interesim që fëmijët e tyre të mësojnë gjuhën e huaj, por pjesa tjetër kanë shprehur interesim për të mësuar një gjuhë, kështu është realizuar edhe kjo kërkesë, përveç aktiviteteve të rregullta.

2.16 Realizimi i programit përgatitor parashkollor

Programi përgatitor parashkollor është organizuar në këtë mënyrë:

- Puna me këto grupe është zhvilluar në kuadër të kopshtit ,
- Puna e disa grupeve edukative të fëmijëve në terren është zhvilluar në kuadër të hapësirave të shkollës fillore dhe objekteve të institucionit.

Janë bërë përpjekje sistematike që të gjithë fëmijët të jenë të përfshirë në programin parashkollor. Hapësira për vijimin e mësimi përgatitor parashkollor është pajisur dhe rregulluar në harmoni me normativat egzistuese. Grupet edukative të fëmijëve i kemi pajisur sipas mundësive me orendi dhe material didaktik. Dhomat e punës në të gjitha grupet, si dhe interieri i hapësirave është i këndshëm për qëndrimin e fëmijëve, falë ambientit të krijuar dhe pajisjeve me lodra të reja, oriendi të reja, etj. Puna edukativo-arsimore me fëmijët e kësaj moshe- parashkollore është realizuar nga edukatorja në bashkepunim të vazhdueshëm me prindërit duke krijuar program karakteristik për grupin e vet.

Sipas rregullores mbi bazat e përgjithshme të programit parashkollor, janë zbatuar bazat e programit parashkollor. Programi është realizuar 4 orë pune të pa ndërprerë me fëmijët. Nga kjo periudhë kohore janë realizuar 3 aktivitete të orientuara me kohëzgjatje prej 30 minutash, ndërsa koha tjetër e punës është menaxhuar në bazë të programit të edukimit dhe arsimit parashkollor. Përgjegjësi i drejtëpërdrejtë për realizimin me sukses të kësaj forme të punës është personeli profesional.

Për zhvillimin e suksesshëm të fëmijës, bashkëpunimi i familjes me kopshtin është parakusht themelor. Bashkëpunimi në mes të personelit pedagogjik dhe prindërve është realizuar në mënyrë të planifikuar dhe sistematike në këto forma³⁰

- informative
- edukative mbjedhjeve të prindërve (4 herë gjatë vitit shkollor)

³⁰(Programi I edukimit dhe arsimit parashkollor, vendimi I MASHT-it 2015)

- vizita individuale të disa prindërve grupeve edukative të fëmijëve, si dhe njohja e tyre me punën që ben institucioni për fëmijët e tyre.
- vizita individuale të prindërve në grupe edukative me anë të së cilës janë njohur me jetën dhe punën e Kopshtit.
- Si formë e bashkëpunimit te prindërve me edukatorë është shfrytëzimi i pjesëmarrjes – prezencës së tyre në Kopsht dhe në grupet në terren gjatë festimit të “ Vitit te Ri “, Dites se Nënave si dhe shfaqja e programit për mbarim të vitit.

2.17 Bashkëpunimi me rrethin shoqëror

Duke ditur rëndësinë e bashkëpunimit me rrethin shoqëror, ky institucion bashkëpunimin me rrethin shoqëror e ka realizuar përmes kontakteve, takimeve, vizitave, bisedave, shfaqjeve së fëmijëve si dhe aktiviteteve tjera të përbashkëta. Po ashtu është realizur me sukses bashkëpunimi me Shkollën fillore, me Shtëpinë e shëndetit, me Qendrën për punë sociale si dhe institucionet e tjera që veprojnë tek ne.

2.18 Përsosja profesionale e kuadrit arsimor

Përsosja profesionale e kuadrove arsimore në gjiun e këtij institucioni ka qenë në harmoni me kërkesat reale. Viteve të fundit janë realizuar seminare dhe trajnime. Pervojet nga këto forma të përsosjes profesionale janë bartur në aktivitetin e edukatorëve. Gjithashtu kopshti është furnizuar e pajisur me literaturë të re dhe në këtë mënyrë është pasuruar biblioteka .

2.19 Realizimi i programit të punës sociale

Aktivitetet që kanë pasur të bëjnë me punën sociale janë kryer në nivel të kopshtit, në nivel të grupeve edukative, në menyrë individuale dhe në kuadër të aktiviteteve të përditshme. Detyrë e këtyre aktiviteteve ka qenë arritja e sigurisë sociale dhe socializimi i fëmijëve, krijimi i kushteve të nejtja për zhvillimin e tyre, nxitja e mundësive zhvilluese dhe mbrojtja adekuate.

Mbrojtja shëndetësore paraqet të gjitha punët të cilat i ndërmarrim për mbrojtjen dhe zhvillimin e shëndetit kolektiv. Këto aktivitete, janë realizuar me institucionet shëndetësore. Në këtë aktivitet kanë qenë pjesëmarrës të gjithë punëtorët, pediatri, inspeksioni sanitare, etj. Gjendja shëndetësore është përcjellë përmes vizitave te mjeku. Puna edukativo-dhëndetësore është

zhvilluar për ditë me prindërit gjatë kontakteve me ta. Ky institucion parashkollor ka siguruar shërbimin shëndetësor si dhe përcjell e kujdeset për mirëqenien e fëmijëve parashkollorë, siç është rasti me marrjen e masave parandaluese për mbrojtjen e fëmijëve nga përhapja e epidemive të gripit gjatë vitit. Po ashtu gjatë gjithë vitit puntorët arsimorë i nënshtrohen egzaminimit mjeksor me qëllim të shmangëjes të çdo lloji të përhapjes së viruseve, etj.

Ushqimi i kontrolluar i fëmijëve është faktor i rëndësishëm për zhvillimin e tyre. Kushtet higjieno - sanitare në kuzhinë janë të mira. Për higjienën e saj të rregulltë dhe të duhur janë të organizuara puntoret që kujdesen për kuzhinën.

Gjatë pranimit të fëmijëve në kopsht, ata pranohen me analiza të gjakut të kryera në institucionin shëndetësor dhe gjatë pushimit mjeksor të fëmijës ata pranojnë për vijim në kopsht me vërtetimin e mjekut. Vërtetimi i mjekut shtetë i nevojshëm edhe pas një muaji të mungesës së fëmijës.

Për realizimin e përmbajtjeve programore, rëndësi të veçantë kanë organet profesionale të kopshtit dhe këshilli drejtues. Këshilli drejtues si organ udhëheqës për periudhën e caktuar ka mbajtur 8 mbledhje në vit. Në keto mbledhje janë shqyrtuar çështje të ndryshme dhe janë marrë vendime me të cilat janë krijuar kushtet për organizim normal të punës. Këshilli drejtues i institucionit kryesisht shqyrton çështje lidhur me krijim e kushteve më të mira të punës, realizimin e planit financiar, programin e punës, propozimin e çmimit, furnizime me mjete themelore e të tjera.

Detyrat e planifikuara janë realizuar dhe janë arritur rezultate solide në realizimin e veprimtarisë së kopshtit. Me gjithë atë, ka pasur raste ku kanë ardhur në shprehje vështirësit dhe problemet e caktuara, gjë që ka ndikuar edhe në rrjedhën e punës së kopshtit, ku hapësira e punës nuk është adekuate.

Me punën dhe angazhimin e të gjithë të punësuarve, kryesisht puntorëve arsimorë, kopshti do të vazhdojë edhe më tutje në përmirësimin e kushteve për qëndrimin e fëmijëve në kopsht, të ngris nivelin dhe kualitetin e shërbimeve që ofron dhe sidomos përkushtimin ndaj fëmijëve e prindërve të tyre.

PJESA E TRETË

3.1 NGA TEORIA NË PRAKTIKË

Për ta arritur këtë mision kaq të rëndësishëm për formimin e fëmijëve, është detyrë e edukatoreve që përmes punës praktike dhe lojës në kopsht ose në klasën parashkollore t'ua zhvillojnë fëmijëve aftësitë e duhura për t'i pajisur ata me shkathtësitë siç janë:

3.2 Zhvillimi kognitiv- zhvillimi i aftësive dhe kapaciteteve njohëse nga lindja deri në moshë të vjetër

Zhvillimi social – ka të bëjë me veprimin e fëmijëve me persona tjerë (prindët, kujdestarët, edukatorët, familjarët, moshatarët dhe të rriturit tjerë. Zhvillimi social i ndihmon fëmijëve të njohë mjedisin social që e rrethon, mjedisin kulturor dhe traditën, si dhe të zhvillojë kuptimin për komunitetin. Sjellja e hershme sociale ndikohet në mënyrë të konsideruar. Nga praktikatat e prindërve për rritjen e fëmijëve duke përfshirë mënyrën se si prindërit realizojnë zbatimin e rregulleve, si japin ndihmën dhe nxitjen fëmijëve së tyre.³¹

Zhvillimi emocional – ka të bëjë me aspektin si ndihet për vetveten dhe për botën që e rrethon, si shpreh ndjenjat, emocionet ndaj vetes dhe të tjerëve. Përmes ed. soc. Te bëhet rritja dhe edukimi i ndjenjës së besimit, miqësis dhe bashkpunimit. Zhvillimi i emocioneve ndikohet nga mjedisi shoqëror dhe mënyra se si njerzit i përgjigjen atyre.³²

Zhvillimi motorik-Aftësitë motorike janë pjesë integrale e procesit të zhvillimit të tërësishëm, veçanërisht gjatë moshës parashkollore. Këto aftësi kanë të bëjnë me zhvillimin e muskujve fine në duar dhe gishterinjë aftëson të shkruarit, prerjen, përdorimin e lugës, mbërthimin e pullave, lidhjen e tojave të këpucëve. Aftësitë motorike të muskujve të mëdhenj përfshijnë muskujt në duar, në këmbë në trup. Këto aftësi përfshijnë ecjen, vrapimin, kërcimin, kapërcimin, hedhjen, ngjitjen, etj.

Zhvillimi gjuhësor-deri në moshën 5 vjeç, shumica e fëmijëve, arrijnë të zotërojnë tingujt e gjuhës amtare. Zhvillimi gjuhësor është procesi më i cilin fëmija mund të kuptojë dhe komunikojë

³¹(MASHT, 2011)

³²(MASHT, 2011)

gjuhën gjatë fëmijërisë së hershme. Në përgjithësi vajzat zhvillohen në aspektin gjuhësor me shpejt se djemët. Zhvillimi gjuhësor reflekton zhvillimin dhe maturimin e trurit.

Zhvillimi matematikor- dhe diturit mbi numrat përfshijnë aftësi të ndryshme, siç janë njohja e numrave dhe emertimi i tyre, numrimi, njohja dhe krijimi i modeleve, formave, si dhe kategorizimi e klasifikimi.

Pra, në saje të përvetësimit të njohurive të duhura, fëmijët do të përgatiten që shkollën fillore ta fillojnë të sigurtë , pa ndjenjën e frikës e inferioriteti.

Me këto shkathtësi të arritura, nxënësit forcojnë gjithashu iniciativën dhe vetbesimin. Vetëm kështu i pajisur, fëmija do të shkojë në klasë të parë, pa e vërejtur shkeputjen zingjirore të edukimit të më tutjeshëm dhe do të jetë në gjendje të ndiej kënaqësi nga puna, suktesi dhe bashkveprimi me të tjerët.

3.3 Hospitimi im në kopshtin e fëmijëve në Zhur

Gjatë qëndrimit në kopshtin e fëmijëve, krahas hulumtimit në bibliotekën, dhe në arkivin shkollës, takimin me ish nxënës dhe trpin arsimor, i përcillja me vëmendje dhe kujdes mësimet e edukatores për të marrë shënime nga orët e mbajtura.

Shënimet, vërejtjet dhe kënaqësitë e mia po i paraqes në vijim :

3.4 Plani, program dhe ditari i edukimit parashkolor në Zhur

Kategoritë:Nënkategoritë:	Muaji Shtator
1 Njohja e vetvetes	1. Identiteti personal dhe mjedisi
2 Të dëgjuarit	2. Të dëgjuarit informativ
3 Aktivitet i ecjes	3. Aktivitetet e ecjes
4 Bashkësitë	4. Llojet e bashkësive

Muaji Tetor

1. Të dëgjuarit	1. Të dëgjuarit efektiv
2. Mjetet dhe materialet teknike	2. Vija , forma, ngjyra
3. Tingujt	3. Tingujt natyrorë dhe muzikorë
4. Lojrat didaktike	4. Forma, madhësia, koha

Muaji Nëntor

1. Aktivitetet e vrapimit	1. Llojet e vrapimeve
2. Të dëgjuarit e tekstit	2. Llojet e teksteve
3. Aktivitetet me plastikë	3. Forma, madhësia, ngjyra
4. Ritmi i fjalëve	4. Ndjenja ritmike me rrokje

Muaji Dhjetor

1. Numri dhe veprimet	1. Veprim me numra (numrim gjësëndeve)
-----------------------	---

- | | |
|---------------------------|----------------------------|
| 2. Sjelljet dhe mjedisi | 2. Njohja dhe sjelljet |
| 3. Aktiviteti i kërcimeve | 3. Llojet e kërcimeve |
| 4. Përvetësimi i leksikut | 4. Të dëgjuarit e leksikut |
-

Kategoritë :

Nënkategoritë :

Muaji Janar

- | | |
|--------------------------|---------------------------------------|
| 1. Të folurit | 1. Të folurit e marrësit e dhënësit |
| 2. Përcaktimi i ngjyrave | 2. Ngjyrat: të ngrohëta dhe të ftohta |
| 3. Ritmi i tingullit | 3. Tingujt e instrumenteve |
| 4. Veprim me numra | 4. Numrat dhe veprimet |
-

Muaji Shkurt

- | | |
|-----------------------------|--|
| 1. Të drejtat tona | 1. E drejta personale dhe e të tjerëve |
| 2. Aktiviteti i zvarritjeve | 2. Zvarritjet nëpër objekte |
| 3. Të folurit aktiv | 3. Të folurit aktiv në grup |
| 4. Aktivitete me modele | 4. Aktivitete në mjedisin shoqëror |
-

Muaji Mars

- | | |
|---------------------------|--|
| 1. Kënga dhe dëgjimi | 1. Mënyrat e të dëgjimit të këngëve |
| 2. Gjatësia, masa, koha | 2. Kuptimi për masën, kohën |
| 3. Kujdesi për higjienën | 3. Higji personale, amb. mjed. jetësor |
| 4. Aktivitetet e ngjitjes | 4. Aktivitete për ngjitje dhe zbritje |

Muaji Prill

- | | |
